



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 20.02.2024)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën për vitin 2023”, përgatitur nga znj. {...}, Këshilltare për Etikën.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Emona Muçi*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
8. ***Markelian Koça*** (anëtar)
9. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor z. **Klodian Kurushi** dhe z. **Ridvan Hado**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.**
4. **Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.**
7. **Arben Lila, përfaqësues të EU4Justice. (në sallë).**
8. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**
9. **Sidorela Driçi, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.**
10. **Birn.**
11. **{...}, gjyqtare, Këshilltar i Etikës.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën për vitin 2023”, përgatitur nga znj. {...}, Këshilltare për Etikën.

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 20 shkurt.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit kërkohet vendimmarrje përreth 8 çështje.

Paraprakisht sot janë prezent për shkaqe objektive zoti Klodian Kurushi dhe zoti Ridvan Hado. Kështu që në qoftë se nuk kemi diskutime mbi rendin e ditës, unë do propozoja që të fillojmë me çështjen e parë, e cila ka të bëjë me shqyrtimin e

projektvendimit “Për miratimin e “Raportit vjetor mbi veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën për vitin 2023”, të znj. {...}.

Siç jeni në dijeni, me vendim të Këshillit znj. {...} është caktuar Këshilltar për Etikën dhe në zbatim të detyrimeve që vijnë nga ligji “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, Këshilltari i Etikës duhet të raportojë përpara mbledhjes plenare të Këshillit një herë në vit, kryesisht gjatë periudhës së janar-shkurtit.

Kështu që pa humbur kohë zonja {...} është prezent. Ftojme zonjën Boksi që të raportojë mbi veprimtarinë e saj.

(Futet në sallën e mbledhjes znj. {...}.)

Naureda Llagami: Përshëndetje zonja Boksi!

Mirë se erdhe në Këshillin e Lartë Gjyqësor!

Siç jeni në dijeni ju mbartni detyrimin që një herë në vit të raportoni përpara këtij Këshilli lidhur me veprimtarinë tuaj në cilësinë e Këshilltarit për Etikën. Kështu që fjala është për ju. Shkurtimisht ku ka konsistuar veprimtaria juaj gjatë këtij viti. Faleminderit!

{...}: Përshëndetje edhe një herë!

Gëzohem që ju takoj personalisht.

Ju faleminderit shumë për mirëkuptimin në radhë të parë, se për shkak të ngarkesës u detyruat që ta shtynit raportimin tim për ditën e sotme. Ju faleminderit shumë.

Në vijim të komunikimeve që ne kemi pasur edhe vitet e tjera, kam depozituar në mënyrë të përmbledhur një raport për veprimtarinë që kam pasur gjatë vitit 2023, natyrisht në zbatim të nenit 83, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Edhe sivjet, fatkeqësisht më duhet të them që komunikimi me kolegët/gjyqtarët nuk ka qenë në nivelin e pritshmërive. Natyrisht ka një lloj rritje në komunikim në raport me vitet e mëparshme, por prapë vihet re një lloj ngurrimi të magjistratëve për të komunikuar me Këshilltarin për Etikën, që mund të jenë dhe unë kam identifikuar disa

shkaqe në raportimin tim, që mbase, e para lidhet me ngarkesën e tyre dhe duke marrë ndoshta me punët e përditshme në ushtrimin e funksionit, nuk e mendojnë më gjatë që një veprim mund të ngrëjë ca dilema etike. Por në fakt, pas publikimit të dy opinioneve, ka pasur një lloj reagimi nga magjistratët, qoftë për përdorimin e telefonit celular, por ajo që ngelet dhe vazhdon të jetë pak shqetësuese është përsëri përdorimi i rrjeteve sociale në fakt.

Me kënaqësi kam vënë re që në një nga komunikimet, një nga postimet në një nga rrjetet sociale të një kolegu, kolegët e tjera kanë reaguar duke i vënë në dukje që shiko se je në kufijtë e shkeljes etike dhe i kanë kujtuar opinionin e Këshilltarit të Etikës. Mendoj që ky ndërveprim është për t'u përshëndetur, pavarësisht se ata nuk i janë drejtuar Këshilltarit të Etikës në vetvete.

Në fakt kjo mungesë komunikimi më ka krijuar pak vështirësi në identifikimin e dilemave etike, për përpunimin e manualit, për të qenë sa më praktikë dhe për të mos ngelur në kuadrin e trajtimit teorik në fakt. Rëndësia e këtij komunikimi, ne e pamë në fakt në një trajnim që zhvilluam në datë 31 janar, 1 dhe 2 shkurt, një trajnim që erdhi si bashkëpunim i projektit EU4Justice (që asiston KLGJ-në dhe Shkollën e Magjistraturës). Aty, nga bashkëbisedimi me kolegët, u evidentuan shumë diskutime në fakt, dhe ajo që mbizotëroi përveç faktit që gjyqtari duhet të ketë të gjitha ato cilësitë (pavarësi, paanësi, integritet), u theksua me shumë forcë që gjyqtari në radhë të parë duhet të jetë i përlur, në kuptimin që duhet të ketë atë kujdesjen në raport jo vetëm me kolegët, me stafin, por edhe me palët në një proces gjyqësor, që në disa raste, në mënyra sporadike, më kanë ardhur informacione që është evidentuar pak shqetësim por që nuk është se është raportuar në një shkallë të tillë që të lindë nevoja për t'u bërë një opinion i përgjithshëm dhe të bëjmë një publikim tjetër, siç u bë në rastin e përdorimit të rrjeteve sociale.

Problematika kryesore lidhet me përdorimin e rrjeteve sociale. Në fakt vijon të jetë pak shqetësues sepse magjistratët natyrisht që kanë të drejtën e lirisë së shprehjes dhe duhet të shprehen dhe komunikojnë për çështje që lidhen me drejtësinë, por në disa raste vërehet një lloj komunikimi, ndërveprimi me palët (avokatë ose juristë të ndryshëm), ku çështje të ndryshme kanë tendencën t'i debatojnë në një komunikim online, që normalisht është jo shumë... le të themi ngrë një dilemë etike, -se pjesa tjetër nuk më takon mua.

Ajo çfarë doja të thoja unë në lidhje me komunikimin tek shkaqet, përveç ngarkesës, dhe natyrisht harta e re gjyqësore që ka filluar tani funksionimin dhe besoj që do japë shumë shpejt edhe rezultatet pozitive, mendoj që nga arsyet e tjera që ka ndikuar në këtë komunikim jo në nivelin e duhur është edhe ndoshta një mungesë informacioni ose një lloj stepie apo ngurrimi që kanë gjyqtarët për t’iu drejtuar Këshilltarit për Etikën dhe ndoshta kjo vjen për faktin që Këshilltari për Etikën zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe akoma ndoshta nuk e kanë (dhe e pamë pak në trajnim) shumë të qartë që Këshilltari për Etikën ka një rol këshillues, pavarësisht se zgjidhet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, nuk ka asnjë lloj iniciative në procesin disiplinor apo në ndonjë lloj ndërveprimi me Këshillin e Lartë Gjyqësor në dëm të tyre (në këtë ide). E vumë re edhe nga trajnimi që gjyqtarët në shumë raste por edhe në raste të tjera kur më kanë komunikuar, më thonë që i jemi drejtuar Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe na kanë thënë që jeni ju Këshilltarja për Etikën, ndërkohë që Këshilli i Lartë Gjyqësor ka një rubrikë të dedikuar, pra kemi adresën, pra janë në faqen “web” të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Adresat e internetit janë të aksesueshme të gjitha. Por shpresojmë që në vijim do kemi një përmirësim sepse në kuadrin e projektit të Bashkimit Evropian (EU4Justice) dhe në bashkëpunim edhe me Shkollën e Magjistraturës (natyrisht me mbështetjen e KLGJ-së), është planifikuar që ky trajnim që u zhvillua tani në fund të janarit dhe fillim të shkurtit, të ketë një zgjatje në kohë, të paktën për aq kohëzgjatje sa ka projekti, në vitin 2025 (në mos u gabofsha). Kështu që besoj që urat e bashkëpunimit me Shkollën e Magjistraturës janë vënë dhe Shkolla e Magjistraturës është shprehur e gatshme për të realizuar edhe trajnime të tjera për ta shtrirë, sidomos në radhët e magjistratëve të rinj që kanë 1-5 vite punë, ku vërehen pak më shumë elementët, le të themi, problematike etike.

Pra përveç trajnimit që ne zhvilluam dhe natyrisht këtu gjej rastin që të falënderoj KLGJ-në dhe znj. Plaku që më asistuan dhe më ndërmjetësuan për të komunikuar me dy përfaqësuesit e projektit EU4Justice. Ne mendoj që edhe në vijim do kemi të njëjtin bashkëpunim frutdhënës për të identifikuar sa më shumë dilema që ai manuali që tani duhet të rishikohet në fakt, se pas trajnimit pashë që kishte nevojë, ai drafti i parë që unë e kisha gati, të ripërpunohet për të qenë sa më konkret, dhe ajo që unë vura re është që nga trajnimi pashë që, të paktën në rastin e përdorimit të telefonit celular, mu krijua

përshtypja që kisha qenë pak e ngurtë në dhënien e opinionit, një opinion pak shumë drastik dhe sugjerimi me shumë të drejtë i ekspertëve spanjollë që ishin të pranishëm ishte që në fakt duhet të jemi jo aq të ngurtë. Por ndoshta situata e përdorimit të telefonave celularë ishte pak shqetësuese dhe ndoshta për momentin ishte pak e nevojshme të ishim pak më të ngurtë dhe që nuk lejohej dhe është e padiskutueshme që nuk lejohet gjatë seancës gjyqësore.

Pra drafti i parë është në fazën e ripërpunimit dhe besoj që brenda një afati sa më të arsyeshëm do të publikohet dhe do të shpërndahet mes kolegëve, që të marrim një “feedback” prej tyre. Pastaj duke pasur një produkt konkret, besoj do të kemi edhe reagime të tjera.

Natyrisht pjesa më e rëndësishme e këtij trajnimi ishte dita e tretë në fakt, ku gjyqtarët që ishin pjesëmarrës, por edhe prokurorët edhe inspektorët e ILD-së (sepse ishin edhe ato pjesë e trajnimit dhe kjo ishte një gjë shumë pozitive), parashtruan shumë dilema që ato mendonin që kanë rëndësi për t’u trajtuar nga Këshilltari për Etikën, për të marrë një lloj qasjeje në lidhje me standardet ndërkombëtare dhe Kodin e Etikës Gjyqësore. Kështu që mendoj që kjo punë do jetë në përfundim e sipër.

Ajo çfarë mua më duhet ta ritheksojë, siç e kam thënë edhe herët e tjera, duke shpresuar që projekti natyrisht do vazhdojë të më asistojë edhe në draftimin e këtij manuali informues, është mbështetja me burime njerëzore, që vazhdon të mbetet pak shqetësues për shkak të ngarkesës dhe faktit që ndryshe nga KLP, unë e ushtroj këtë funksion pa shkëputje nga detyra dhe nga funksioni.

Unë këto dy gjëra kisha.

Në mënyrë më të detajuar, jua kam depozituar.

Në qoftë se keni pyetje, sugjerime, vërejtje.

Naureda Llagami: Do të ftoja kolegët nëse kanë pyetje ose sugjerime mbi veprimtarinë.

Alban Toro: Thjesht mua më ka shqetësuar ky fakti i konvertimit të gjyqtarit në “profesor të së drejtës”, pra siç thatë edhe ju, shpeshherë nëpër rrjetet sociale, gjyqtarë të

caktuar marrin përsipër të trajtojnë tema dhe akoma më keq, të hyjnë themelit të gjykatave, dhe akoma më keq kur këto janë vendime të Gjykatës së Lartë.

Parimi i përgjithshëm është që vendimet e gjyqësorit nuk interpretohen, ato zbatohen, ndërkohë që pjesën e interpretimit ia lejmë të drejtës dhe pedagogëve përkatës që janë pranë fakulteteve. Nuk e di, a duhet gjetur një mekanizëm se si të mund të frenojmë këtë lloj qasje në rrjetet sociale, ku gjyqtarët marrin përsipër të trajtojnë tematika që në opinionin tim është krejtësisht në kundërshtim me pozitën që ata kanë dhe që kompromentojnë në mënyrë të rëndë atë paanësi të cilës nesër-pasnesër, me të vërtetë pala mund t'i drejtohet duke kërkuar edhe përjashtimin, e s'po them pjesën e etikës në raport me kolegët të cilët e kanë shpallur atë vendim dhe kanë gjykuar në atë pjesë, nuk do të thotë që opinionin e gjyqtarit në rastin konkret do të jetë opinion i drejtë sepse ai panel i atij vendimi ka qenë më shumë se një dhe kur ka më shumë se një do të thotë që pak a shumë drejtësia është balancuar në atë grup paneli dhe nuk mund të përkojë me prezumimin e së drejtës që ka gjyqtari për rastin konkret. Pra shqetësues është fakti që kompromentohet tërësisht figura e gjyqtarit, del nga çdo aspekt gjatë së cilës ai është detyruar të veprojë në ambientin ku ai duhet të veprojë dhe nuk duhet të flasë. Nëse do duhet të gjejmë një mekanizëm, na e propozoni. Nëse duhet të rregullojmë diçka tek Kodi i Etikës në këtë aspekt, na e propozoni.

Aspekti i dytë është pastaj pjesa e veshjeve. Nuk e di, keni pasur raste kur veshjet e gjyqtarëve kanë qenë jo fort korrekte? Sepse edhe ky është një aspekt dhe ka të bëjë me performancën dhe besimin që ka tek drejtësia publiku. Nuk keni pasur raste të tilla të këtij fenomeni?

{...}: Jo! Për aspektin e veshjes, jo.

Por mbase mund të futet në kuadrin e disiplinës? Pra ndoshta mund të jetë pjesë e... Për aspektin e veshjes nuk është se kam pasur ndonjë sinjalizim. Pra pyetjet më të shumta më kanë ardhur në fakt për përdorimin e rrjeteve sociale, është e vërtetë. Ky ndërveprimi i gjyqtarëve me avokatë dhe juristë është shqetësues. Në një rast Kryetari i Gjykatës e ka ftuar gjyqtarin që ka bërë këtë ndërveprimi dhe ai ka thënë: -“Stop”, po më cenon pavarësinë. Domethënë është tentuar.

Unë ndërhyj në momentin që ato më drejtohen. Dhe pastaj i thashë kryetarit të gjykatës që, okej, mu drejto me një opinion ose diçka që unë të marrë shkas dhe të shtjelloj akoma më shumë opinionin për rrjetet sociale sepse opinionin ka qenë pak a shumë shterues. Ka tentuar të japë të gjitha elementët që ato duhet të tregojnë vetëpërmbytje. Unë e kam thënë edhe në raportimet e tjera në lidhje me sugjerimin që ju thoni që disa vende kanë udhëzues, pra që gjithsesi ngelet si puna e Kodit, jo aq shumë i detajuar, por për rrjetet sociale ka në disa vende, nuk janë shumë, që kanë bërë udhëzues të përgjithshëm për përdorimin e rrjeteve sociale nga gjyqtarët. Janë pak sepse vazhdon kjo dilema. Në fakt në Kodin e Etikës kemi vetëm një dispozitë, vetëm një rresht “duhet të shfaqë vetëpërmbytjen në përdorimin e rrjeteve sociale”, dhe ndoshta unë edhe e kam sugjeruar në fakt. Në momentin kur bëra atë opinion, e kam sugjeruar edhe në raportimin e kaluar që ndoshta një udhëzues pak më i detajuar. Për shembull për shkak të trajnimit pashë që KLP e kishte pak më të detajuar dispozitën që rregullon përdorimin e rrjeteve sociale. Ndoshta është momenti që të bëjmë një lloj ndërhyrje, sepse në fakt po kthehet pak në shqetësim. Dhe në rastin konkret, në një rast të caktuar, njëri nga kolegët ka ndërhyrë pikërisht në një moment, kur njëri nga magistratët e rinj ka komentuar një vendim të Gjykatës së Lartë, që për mua duhen komentuar, por jo nga gjyqtarët. Domethënë gjyqtarët duhet të kenë shumë kujdes, shumë vetëpërmbytje kur të komentojnë. Përderisa vendimi është publik, mund ta komentosh, por jo të kalosh në ofendime, domethënë në komente të tilla që mund të merren edhe fyese, që “këto nuk njohin ligjin”, apo “këto nuk dinë”, që besoj është një fenomen që e keni hasur edhe ju në ndonjë praktikë këtu. Domethënë kjo qasje ul besimin e publikut tek drejtësia sidomos kur konteston një vendim. Kjo nuk do të thotë që gjyqtarët me njëri-tjetrin të mos e kontestojnë një vendim, qoftë edhe të Gjykatës së Lartë, që mund të mos jenë dakord. Pastaj do ta zbatojë, në qoftë se është njehsues, patjetër që po. Dhe në atë rast, njëri nga kolegët e mi kanë ndërhyrë, se unë nuk e kisha parë dhe ai pastaj i ka fshirë pastaj komentet që kishin tendencë të ishin pak “cenuese” (nuk po përmend ndonjë term, se si Këshilltare mua s’më takon), por i kam thënë edhe opinionin dhe janë fshirë nga rrjeti LinkedIn ku ishte postuar e postuar dhe kjo në fakt kërkon ndoshta një ndërhyrje, ndoshta një udhëzues, ndoshta një detajim i kësaj dispozitës mbase nga Këshilli i Lartë Gjyqësor

në Kodin e Etikës, mund të detajohen dy-tre gjëra.

Alban Toro: Meqenëse juve keni fituar një eksperiencë në këtë fushë që është goxha e panjohur në aspektin e gjyqësorit, do të ishte mirë, qoftë edhe duke investuar partnerët, Këshilli nuk e ka problem të financojë çfarëdo lloj investimi në këtë pjesë, ta detajonim këtë pjesën e atij perifrimit të vogël tek ajo rregullorja e etikës në mënyrë që, jo vetëm niveli mesatar i një personi me njohuri të kufizuara të kuptojë se ç'është pjesa e kufizuar e shprehjes së gjyqtarit tek palët e treta, por të jetë edhe më e detajuar, duke parashikuar që automatikisht ai bëhet subjekt i procedimit disiplinor, sepse nuk mund të shkojë kjo “që unë kam rezerva për një vendim gjyqësor” dhe për më tepër një gjyqtar i cili vesh veshjen e gjyqtarit, të ngrejë pretendimet të pjesës që “ia kanë futur kot” apo që dalin krejtësisht jashtë etikës dhe që për mua ai duhet të ketë probleme psikologjike, e para, dhe ndoshta është rasti që edhe për gjyqtarët nëpër gjykata të caktojmë një psikolog sepse duke trajtuar traumat e të tjerëve ata përfitojnë nga traumat e tjerëve dhe traumatizohen për vete.

Kështu që në këtë aspekt, kthehet në shqetësim për të gjithë. Por mua më ngacmon edhe pjesa që nëse ne tentojmë të rrisim besimin e publikut, këto sjellje nuk është se të çojnë, të çojnë tek e kundërta, dhe nuk mund të tolerohet të paktën nga Këshilli. Të parashikojmë një dispozitë ku një sjellje e tillë të klasifikohet si subjekt i ILD-së dhe ndoshta atje mund të ketë mundësi edhe ta elaborojë atë pjesën e kontestimit që ka për vendimin gjyqësor, por jo tek palët e treta apo në publik sepse nuk përkon me natyrën e memecesisë së gjyqtarit në shoqëri. Për fat të keq gjyqtari është memec. Nuk mund të pretendojë që vendimi është i drejtë apo... Kontestohet në një shkallë më të lartë dhe le t'ia lejnë pedagogut pastaj ose ta ndajnë rolin, o janë pedagog ose janë gjyqtarë. Se të dyja bashkë kam përshtypjen që janë dy gjëra që nuk shkojnë fare.

Këto të dyja ishin shqetësimet që unë mund të transmetoj.

{...}: Faleminderit!

I mbajta shënim. Mbase në bashkëpunim edhe me projektin “EU4Justice”, patjetër mund të propozojmë ndoshta shumë shpejt një amendim ndoshta të asaj

dispozitës në Kodin e Etikës, për ta bërë ndoshta më të detajuar sesa thjesht një vetëpërbajtje. Se si duket vetëm “vetëpërbajtja” nuk mjafton.

Naureda Llagami: Ndonjë pyetje tjetër?

{...}: Meqenëse zonja Luli ma shtroi këtë për median, njëra nga dilemat etike që na u shtrua në trajnimin që ne ishim, ishte dhënia e intervistave nga gjyqtarët, e para dhe pjesëmarrja... Okej, një gjyqtar mund të shkruajë, mund të bëjë edhe libra, edhe të japi ca opinione që mund të vënë nesër në dyshim paanësinë e tij për çështje të ngjashme, sepse është tendenca që okej, të shkruajmë një artikull problemor mund ta pranojmë, se duhet, ndoshta gjyqtari kupton pak më mirë defektet e ligjit, etj., etj., gjatë ushtrimit të funksionit të tij, ku i kanë dalë ato problematikat, por kanë atë qasjen që të thonë edhe atë konkluzionin që është kështu si them unë dhe kjo është zgjidhja më e drejtë, dhe nesër-pasnesër mund të kenë një çështje të ngjashme dhe i bie që, të isha prokurori ose pala tjetër, ndoshta mund të thoja që (sepse komentojnë edhe çështje civile dhe penale) edhe mund të thotë që prit, unë kërkoj përjashtimin, sepse në filan medium, rrjet social, ose në filan libër, ose artikull, ke thënë këtë mendim, i ke dhënë zgjidhje. Kështu që ti do t'i qëndrosh.

Kështu që ishte një nga pyetjet që na u shtrua.

Naureda Llagami: Ju lutem përdorni mikrofonin në qoftë se doni të bëni pyetje, sepse nuk dëgjoheni nga të tjerët.

Në fakt, kisha unë. Unë përgëzoj veprimtarinë tuaj.

Për herë të parë ju keni dalë dhe keni qenë më aktive edhe në media vetë, një gjë që personalisht e vlerësoj shumë, sepse mendoj që ku ka më mirë sesa një gjyqtar të jetë aktiv dhe të sqarojë. Nga veprimtaria jonë këtu, ajo që kemi identifikuar, të paktën në kuptim të dilemave etike, kryesisht janë sjellje, veprime apo mosveprime që ndodhin me brezin e ri. Brezi i ri i magistratëve, çdo vit e më shumë, konstatojmë sjellje jo shumë etike në kuptimin e vetëpërbajtjes, në kuptimin e marrëdhënieve, që ju thatë, me njeri-tjetrin, në kuptimin e marrëdhënieve që kanë me palët apo qoftë edhe me marrëdhëniet

me stafin. Ajo që unë do të sugjeroja në fakt, si e shoh unë në aspektin e një personi që ka kontribuar në Këshill, por edhe në aspektin e të parit nga jashtë, është që dilemat etike duhet të jenë pjesë e formimit të tyre më të thellë, jo thjesht një Kod Etik, por duke diskutuar dilemat etike me çështje, prandaj do doja të theksoja faktin e këtij manuali. Pse? Sepse duhet të ndërgjegjësohen që të gjithë në mënyrën se si e ushtrojnë veprimtarinë e tyre. Fakti që zgjedhin të jenë gjyqtarë, nuk është vetëm fakti që ata duan të kenë pushtetin e gjyqarit, por ka edhe disa kufizime dhe këto kufizime duhet t'i kenë parasysh që në ditën një, që kanë vendosur për të qenë gjyqtarë. Këto kufizime, bashkohem me kolegun, lidhen edhe me dukjen, lidhen dhe me sjelljen, lidhen dhe me paraqitjen, lidhen me të gjithë komponentët e të qenit gjyqtarë, që në thelb në fakt duhet të jesh një qytetar i mirë. Këtë e kam thënë publikisht, ia kam thënë edhe magistratëve të rinj. Por ajo që unë identifikoj është që pasi ne mbarojmë atë shkollën aty, nuk e di pse të gjithë kandidatët magistratë i humbasin këto vlera (ndoshta edhe nuk i kanë pasur) dhe më pas kalojnë në një shfaqje, që në thonjëza do të thoja, deri në një "arrogancë", dhe ky nuk është ai brezi që ne duam të kultivojmë.

Prandaj do të doja në fakt që përveç aktivizimit tuaj si Këshilltare Etike, sepse sot ne në përditshmëri, pavarësisht, se ne nuk po i themi këtu, sepse janë gjëra që ndoshta nuk duam t'i pranojmë, sepse mendojmë që të gjithë duhet të reflektojmë në sjelljet tona, por në fakt sot ajo që i mungon një magistrati (flas kategoria e brezave të rinj) është një sjellje e vetëpërmbytjes dhe këtë ne e shohim që në komunikimet shkresore që na sjellin, që në komunikimet që kontaktojnë Këshillin dhe në fakt vihemi përpara një përgjegjësie që a është ai modeli dhe portreti i një gjyqtari që ne duam. Kur ato sillen në këtë lloj mënyre me kolegun, kur sillen në këtë lloj mënyrë me një magistrat tjetër, me një autoritet si Këshilli i Lartë Gjyqësor, çfarë ne mund të pretendojmë në sjelljen e tyre ndaj një qytetari?

Kështu që unë në fakt do të kisha si sugjerim, që ndoshta me mbështetjen e projekteve, ky manual të përfundojë. Mirë-keq të kemi një manual dhe mirë-keq të fillojë një set trajnimesh pikërisht për magistratët e rinj, që të kuptojnë se çdo të thotë të sillesh, jo thjesht të kesh njohuri për kodin dhe për ligjet, se të jesh magistrat nuk do të thotë të dish vetëm ligjin, por duhet edhe të japësh një model, gjë që ne sot e kemi vështirësi me

magjistratët, me brezat e rinj që na dalin, me dinamikat dhe problemet që ata kanë. Kështu që unë, e para, do t'ju falënderoja për punën, do ju falënderoja për prezencën dhe pse jo t'ju inkurajoja që të jeni sa më aktive edhe në media, edhe për çështje të cilat ka dilema, do të ishte mirë kur ju flisni, sepse të gjithë ne dëgjojmë kur ju flisni. Por pse jo të shkojmë në një hap më tej që të bëjmë një set trajnimesh, sepse ajo që unë ndiej sot që ka nevojë sistemi, flas për gjeneratat e reja që po na dalin, është pikërisht një vetëpërmbytje dhe një etikë në komunikim dhe në sjelljet e tyre.

{...}: Faleminderit!

Faleminderit shumë për çdo sugjerim.

Naureda Llagami: Nëse nuk kemi ndonjë diskutim.

Markelian Koça: Një sugjerim të vogël.

Nisur nga fakti që ju na thatë që keni eksperiencë të mirë me këtë trajnimin që bëtë, situata reale e gjyqësorit është që gjyqtarët janë shumë të ngarkuar. Po të shikoni edhe nga eksperiencia ime si ekspert në Shkollën e Magjistraturës, sidomos muajt e parë të vitit, pjesëmarrja është shumë e vogël. Duke qenë që trajnimi, nëse organizohet kjo në formë trajnimi nuk është detyrues për gjyqtarët, do të sugjeroja që brenda mundësive dhe burimeve që keni, këto trajnime të shtrihen në të paktën, në rang rajonal, të shkoni ju te gjykatat, sepse edhe kalendari i shkollës për fat të keq vjen dy javë përpara data e seminarit, ndërkohë që gjyqtari mund të jetë edhe gjashtë muaj në avancë me planifikimin. Kështu që me gjithë dëshirën e mirë që mund të ketë gjyqtari të ndjekë trajnime të tilla, e ka të pamundur objektivisht, sepse ka caktuar data gjykimesh dhe vihet gjithmonë në dilemën, të shtyjë gjykimet ku pala ka gjashtë muaj që pret seancën apo të shkojë të marrë pjesë në trajnim. Nuk e di sa janë mundësitë tuaja, por që do të ishte më e mirë, sepse nga ana tjetër e shikoj shumë të vlefshme edhe atë që tha Kryetarja, jo vetëm për brezat e rinj, edhe për ne që jemi më të vjetër, përballja me përdorimin e celularit, rrjetet sociale, mund të jetë problematikë e të gjithë gjyqësorit, kështu që ndoshta këto trajnime janë të mira që të zhvillohen duke marrë masa që sa më shumë gjyqtarë, sa më

shumë magjistratë të marrin pjesë në këto trajnime ose takime. Faleminderit!

{...}: Në fakt një nga sugjerimet që ne kishim me projektin pas përfundimit të trajnimit të parë ishte, e para sepse ishte një trajnim treditör dhe shumë i gjatë dhe normalisht u vu re ajo edhe tek komunikimi me gjyqtarët dhe prokurorët që ishin të pranishëm dhe tjetra, është menduar që të bëjmë një tur, por tani janë këto aspektet e mbështetjes me burime njerëzore e financiare, që besoj do të trajtohen, do të zgjidhen në vazhdimësi nga ana e projektit. Projekti është i gatshëm të bëjmë edhe trajnime rajonale, natyrisht të shkojmë nëpër gjykata, të mbledhim sa më afër, ndoshta 2-3 gjykata bashkë, që të kemi sa më pranë dhe të trajnojmë sa më shumë gjyqtarë. Ne patëm target grupi, meqenëse Irena po ma kujton, për magjistratët e rinj, por në fakt na erdhën për shkak të kalendarit dhe angazhimit, na erdhën shumë magjistratë që kanë edhe goxha eksperiencë në detyrë. Ky ndërveprimi ishte i mirë gjithsesi, sepse edhe të rinjtë po dëgjonin me kureshtje reagimet e gjyqtarëve më me eksperiencë që natyrisht qoftë edhe në komunikim dalloj pak diferenca, - me thënë të drejtën.

Ju faleminderit të gjithëve për sugjerimet.

... Nuk qenka e shtypur. Kërkoj ndjesë. (*mikrofoni ka qenë i fikur.*)

Ndërsa për pjesën e medias nuk e di sa interesant mund të jemi.

Naureda Llagami: Unë mendoj që është pozitive kur ju flisni. Për çdo çështje që kemi një reagim nga mediat dhe se si është veprimtaria, sjellja, mosveprimi i një gjyqtari, në fakt do të ishte mirë që ju ta jepni një opinion, jo t'ia lëmë gjyqtarit vetë që të sqarojë median apo t'ia lëmë një kryetari të gjykatës që të sqarojë për llogari të gjyqtarit. Kur kemi çështje etike në fakt është shumë mirë kur ju flisni, sepse dëgjojnë të gjithë.

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, shumë faleminderit për prezencën dhe për ndarjen e diskutimeve dhe shqetësimeve tona.

Mund të vazhdoni për të lejuar Këshillin të vijojë.

{...}: Faleminderit ju për mundësinë!

(Largohet zonja {...}.)

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votimin e raportit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Miratimin e raportit vjetor mbi veprimtarinë e Këshilltarit për Etikën, për vitin 2023, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 20.02.2024)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për vitin 2022”, relator znj Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Emona Muçi*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Alban Toro*** (anëtar)
- 7. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 8. Markelian Koça*** (anëtar)
- 9. Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor z. **Klodian Kurushi** dhe z. **Ridvan Hado**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.

7. Arben Lila, përfaqësues të EU4Justice. (në sallë).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së.

9. Sidorela Driçi, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

10. Birn.

11. {...}, gjyqtar.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për vitin 2022”, relator znj Irena Plaku.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen e dytë.

Në fakt kjo çështje ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për vitin 2022. Gjyqtari ka ardhur. Kështu që e ftojmë gjyqtarin në sallë.

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtari, z. {...}.)

Naureda Llagami: Përsëndetje z. {...}!

Siç jeni vënë në dijeni, nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor do merret në shqyrtim projektraporti juaj mbi vlerësimin etik dhe profesional për vitin 2022. Procedura që ndjek Këshilli në miratimin e projektraportit është e tillë që fillimisht i jepet fjala relatores. Më pas ju jepet fjala juve lidhur me kundërshtitë që mund të keni, shkurtimisht, sepse Këshilli është vënë në dijeni nga ana e relatores mbi kundërshtitë tuaja mbi përmbajtjen e projektraportit dhe më pas, pasi ju t'i shfaqni ato shkurtimisht, ju do largoheni për të lejuar Këshillin mbi miratimin e projektraportit. Kështu, sipas procedurës, fjalën e ka zonja Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit!

Shkurtimisht do ju paraqesë në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, me të cilat jeni njohur, së bashku me kundërshtimet që janë paraqitur nga ana e gjyqtarit pas njoftimit me projektraportin e vlerësimit. Këto do lexohen në mënyrë të përmbledhur duke u ndalur pak më gjatë tek treguesit që gjyqtari ka paraqitur edhe kundërshtime. Kundërshtimet do t'ia lë gjyqtarit duke qenë se është paraqitur personalisht.

Procedura e vlerësimit ka filluar me vendimin nr. 325, datë 14.06.2023, "Për fillimin e procedurës së përshpejtuar të detyruar të vlerësimit etik dhe profesional. Më pas, në projektraport është pasqyruar e gjithë procedura e ndjekur për administrimin e burimeve të vlerësimit. Nga ana e nëpunëses përgjegjëse është paraqitur pas hartimit të raportit analitik, në datë 15.12.2023 është paraqitur raporti analitik dhe nga ana e KEVP është vendosur plotësimi i procedurës.

Shkurtimisht po ju paraqes vlerësimin për katër kriteret e vlerësimit, konkretisht: Aftësia profesionale e gjyqtarit, për treguesin 1.A.a Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave. Për këtë tregues gjyqtari është vlerësuar maksimalisht. Në konkluzion rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për përshkrimin dhe analizën e fakteve, si të atyre me natyrë procedurale, në të cilat jepet një panoramë e qartë e ecures së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore, në rastet kur elementët proceduralë lidhen ne trajtimin e kërkesave të palëve, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes, të cilët paraqiten në mënyrë koncize, të plotë

dhe analitike, duke integruar përgjithësisht provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Gjithashtu gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes, si dhe në përcaktimin e qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes.

Sa i përket treguesit 1.A.b Aftësia për të interpretuar ligjin, referuar burimeve të vlerësimit është arritur në konkluzionin se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit material dhe procedural në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter civil apo penal. Evidentohet një kujdes i gjyqtarit për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe të Gjykatës Kushtetuese, si dhe për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetimin e vendimit. Për sa më sipër, për këtë tregues, aftësia e tij është vlerësuar shumë e lartë, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket treguesit 1.B.a Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit. Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme. Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në thonjëza). Gjithashtu është evidentuar që përdor të gjitha shkronjat e alfabetit të gjuhës shqipe, përdor shenjat e pikësimit, thonjëzat, simbolet, etj.

Gjyqtari përdor fjali me gjatësi mesatare dhe në disa raste edhe fjali më të gjata, si pasojë e vazhdimësisë së mendimit juridik të shprehur, por kjo nuk krijon paqartësi, pasi në çdo rast rezulton se mendimi është shprehur në mënyrë të thjeshtë dhe të kuptueshme. Të gjitha vendimet janë organizuar në nënndarje, të identifikuar me tituj dhe me paragrafë të numërtuar duke orientuar qartë për përmbajtjen e tyre, të cilët lidhen me

njëri-tjetrin në mënyrë kronologjike dhe vazhdimësisë së mendimit.

Referuar sa më sipër është arritur në konkluzionin se për këtë tregues aftësia e tij është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Sa i përket 1.B.b Strukturës së qëndrueshme dhe të mirë organizuar e vendimit.

Gjyqtari, në hartimin e vendimit, ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar nga pikëpamja formale, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale apo të themelit të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Këto të fundit vijnë gjithnjë si mbyllje e procesit të arsyetimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese-arsyetuese në nënndarje, të identifikuara me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë dhe në të gjitha rastet, këto pjesë janë ndarë në paragrafë, të cilat e lehtësojnë shumë të kuptuarit e vendimit duke mundësuar referimin në paragrafët e mësipërm. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të çështjes, trupi gjykues kërkesëpadia apo palët ndërgjyqëse.

Pjesa përshkruese është e ndarë në disa nënpjesë, konkretisht në: rrethanat e çështjes dhe përshkrimi dhe analiza e tyre; vlerësimi i gjykatës, të cilët më pas kanë edhe nëntituj të tjerë.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarit dhe sekretares gjyqësore. Konstatohet se vendimi është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës: për çdo kërkim të objektit të padisë; për përgjegjësinë penale, etj.,

Në konkluzion është arritur se gjyqtari ka aftësi të larta në ndjekjen e një strukture të organizuar të vendimit, të ndarë në tituj dhe gjithmonë mendimi është ndarë në paragrafë të numërtuar. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuara kryesisht nga gjykata, parashtrimi i rrethanave të faktit, pretendimet e palëve ndërgjyqëse, të cilat janë përgjithësisht janë pjesë e rrethanave të faktit, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen

nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve.

Sa më sipër është arritur në konkluzionin se aftësia e tij është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Sa i përket treguesit 1.B.c Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik, edhe për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka një aftësi shumë të lartë, konkretisht duke vlerësuar tërësinë e tyre referuar burimeve të vlerësimit, duke i vlerësuar ato në tërësinë e tyre në raport me natyrën e çështjes, komplekse ose jo, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në lidhje me këtë tregues. Konstatohet së vendimet gjyqësore burim vlerësimi, në varësit të kompleksitetit të çështjes dhe pretendimet e palëve, në pjesën analitike të tyre përmbajnë argumenta të lidhura me njëri-tjetrin, duke i ndalur shkurtimisht tek evidentimi i lidhjes shkak-pasojë në raport me konkluzionet për zgjidhjen e çështjes. Gjyqtari i kushton rëndësi analizimit të pretendimeve të palëve në raport me ligjin që gjen zbatim si dhe me rrethanat konkrete të çështjes, duke i dhënë përgjigje të argumentuar si për çështjet e procedurës ashtu dhe ato për themelin e çështjes. Përgjithësisht, arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Për sa më sipër, lidhur me këtë tregues është propozuar pikëzimi i tij me 25 pikë.

Propozimi për kriterin e parë, aftësia profesionale e gjyqtarit është pikët 100, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket kriterit të dytë "Aftësia organizative e gjyqtarit".

Konkretisht për treguesin 2.A.a Respektimi i afateve ligjore, sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 224 çështje për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, 43 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ndërsa 181 çështje janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Referuar raportit të çështjeve të cilat janë shqyrtuar tej afatit ligjor, me numrin e çështjeve për të cilat parashikohet afat ligjor, ka rezultuar që gjyqtari ka gjykuar 19.1% të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në përlllogaritjen e afateve ligjore, pas një analize e të dhënave të burimeve të vlerësimit ku është zbritur periudha e lejes vjetore dhe e festave të fundvitit apo

mbartjeve të dosjeve ka rezultuar se nga këto 43 çështje janë zbritur edhe 9 çështjet e tjera të konsideruara të përfunduara brenda afateve ligjore.

Për sa më sipër raporti tashmë i çështjeve pas një analize tjetër të të dhënave statistikore ka rezultuar 15% të çështje që janë shqyrtuar tej afatit ligjor, që sipas metodologjisë, pikëzohet me 12 pikë.

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit.

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton gjatë periudhës njëvjeçare gjyqtari ka gjykuar 571 çështje nga të cilat 224 kanë qenë me afat ligjor, pra, 39.2 % kanë qenë me afat ligjor.

Ka rezultuar se gjyqtari gjatë kësaj periudhe ka ushtruar edhe detyrën e zëvendëskryetarit të gjykatës, çka nënkupton një ngarkesë sasiore në masën 40 % të ngarkesës minimale në atë gjykatë, që konsiston kryesisht në një pjesëmarrje më të pakët në short.

Duke qenë se standardi sasior është tejkaluar me 64.5% të çështjeve, nga ana ime është propozuar rritja e nivelit të vlerësimit me një nivel, duke e rritur në nivelin maksimal me 15 pikë. Pra për këtë tregues gjyqtari është propozuar në pikëzimin maksimal me 15 pikë.

Sa i përket treguesit 2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 347 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 165 prej tyre ose 47.5 % janë gjykuar tej standardit minimal kohor. Edhe për këtë tregues, në llogaritjen e afateve të standardit minimal është bërë një përlllogaritje tjetër në ndryshim nga Raporti Analitik, duke hequr periudhën që përfshihet nga leja vjetore (35 ditë) dhe festat e fundvitit dhe afatin e mbartjes së dosjeve. Pas një rillogaritje të të dhënave statistikore ka rezultuar se nga 32 çështje që do të llogariten të gjykuara brenda standardit minimal dhe do t'i zbriten çështjeve 169 të përcaktuara në Raportin Analitik, duke mbetur kështu 137 çështje të cilat rezultojnë të jenë shqyrtuar tej standardit minimal

që përkon me 39.4% të çështjeve të vlerësuara tej standardit minimal.

Sipas metodologjisë së pikëzimit kjo përqindje pikëzohet me 2 pikë.

Edhe për këtë tregues, në metodologjinë e pikëzimit është parashikuar që të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundime të cilat nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit.

Në rastin konkret, për sa i përket aspektit sasior, ashtu siç u arsyetua edhe tek treguesi tjetër, ka rezultuar se raporti i çështjeve të gjykuara me palë kundërshtare është 329 çështje dhe 242 çështje pa palë kundërshtare, çka nënkupton që standardi minimal nga 200 çështje është tejkaluar me 129 çështje apo me 64.5 %.

Në përcaktimin e pikëzimit në këtë rast në një nivel të ndryshëm është marrë parasysh edhe fakti që gjyqtari ka kryer edhe detyrën e zëvendëskryetarit të gjykatës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës në kushtet edhe të mungesës së kryetarit të gjykatës, e cila nënkupton në fakt një pjesëmarrje në short të çështjeve në një ngarkesë më të ulët se gjyqtarët. Sipas rregullave të fundit të miratuara nga ana e KLGJ-së rezulton 75% të punës së gjyqtarit, ndërsa më parë ka qenë sipas vendimit të ish-KLGJ-së 40%.

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit (137 çështje) me numrin total të çështjeve; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen, të cilat përgjithësisht nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit; (iii) tejkalimin e standardit sasior me 129 çështje, apo me 64.5 %; (iv) faktin se gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari ka ushtruar edhe detyrën e zëvendëskryetarit; (v) shqyrtimi i një numri të madh të çështjeve me afat ligjor prej 224 çështje që kërkon angazhim të madh të gjyqtarit, kam vlerësuar që për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal duke arritur në 5 pikë, pavarësisht se ka rezultuar që standardi minimal është tejkaluar me 39.4%.

Sa i përket 2.A.c Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, referuar burimeve të vlerësimit konkretisht të pasqyruara në Raportin Analitik ka rezultuar se për shumë nga kategoritë e çështjeve koha mesatare është tejkaluar nga ana e gjyqtarit. Konkretisht, referuar të dhënave statistikore, rezulton se kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më i gjatë se standardi për shumicën e kategorive, pasi nga 10 kategori, 8 kategori

janë shqyrtuar në tejkalim të këtij standardi. Referuar metodologjisë së pikëzimit, kjo llogaritje matematikore përkon me 2 pikë.

Duke qenë se për dy nënkategori çështjesh afati është tejkaluar në 14 dhe 18 ditë, i cili mund të konsiderohet i papërfillshëm referuar standardeve minimale të përcaktuara për secilën nga kategoritë, është menduar që gjyqtari të pikëzohet me një nivel tjetër. Por duke marrë parasysh volumin e çështjeve, , faktin se një numër i lartë i çështjeve kanë qenë me afat ligjor, angazhimin e gjyqtarit në trup gjykues, funksionin e gjyqtarit si zëvendëskryetar i gjykatës si dhe faktin se përgjithësisht gjyqtari ka treguar kujdes për zhvillimin e gjykimit brenda afateve, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me dy nivele më të larta se ai që i përket të dhënave statistikore, duke e pikëzuar me 4 pikë. Pra për këtë tregues, gjyqtari është propozuar që të vlerësohet me 4 pikë në ndryshim nga të dhënat statistikore.

Sa i përket 2.A.ç Rendimenti i përfundimit të çështjeve.

Referuar Raportit Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit, viti kalendarik 2022 si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (571 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (706 çështje) ka rezultuar 80.87 %, përqindje e cila sipas metodologjisë pikëzohet me 2 pikë.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit e cila ka përcaktuar se të dhënat statistikore analizohen me qëllim për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, konkretisht sa i përket treguesit sasior rezultoi se gjyqtari ka kaluar standardin minimal sasior me 64.5% apo me 129 çështje. Duke marrë parasysh se ka ushtruar edhe detyrën e zv/kryetarit të gjykatës është propozuar një pikëzim tjetër. Kështu në konkluzion, megjithëse rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit ka rezultuar 80.87%, përqindje që referuar metodologjisë që pikëzohet me 2 pikë, faktin se një përqindje e tillë është në kufirin e përqindjes 81 – 87 %, përqindje që pikëzohet me 4 pikë, duke pasur parasysh faktin se gjyqtari në këtë periudhë vlerësimi e ka tejkaluar standardin me 129 çështje, faktin se gjatë kësaj kohe ai ka ushtruar edhe detyrën e zëvendëskryetarit, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues duhet të pikëzohet në tre nivele më të larta pikëzimi se sa rezulton nga përllogaritja matematikore, duke arritur në pikëzimin me 8 pikë.

Sa i përket 2.A.d Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor. Në projektraport janë pasqyruar në mënyrë të detajuar afatet e arsyetimit të vendimit për secilën nga kategoritë e çështjeve dhe ku ky afat ka rezultuar më i gjatë se afati i parashikuar në ligj. Kështu që nuk po e përsëris.

Nga të dhënat ka rezultuar se koha mesatare e arsyetimit të vendimit është më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, që sipas Metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 12 pikë.

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit është përcaktuar se duke pasur parasysh të dhënat statistikore, nga ana e Këshillit mund të rritet në një pikëzim më të lartë duke zbatuar koeficientin me 20%, pra mund të arrihet në një nivel më të lartë pikëzimi. Duke iu referuar të dhënave statistikore ku ka rezultuar se gjyqtari ka dhënë 571 vendime, mesatarisht rreth 52 vendime në muaj, si dhe aspekte të tjera që lidhem me kushtet e punës, konkretisht kohën që gjyqtari shpenzon në gjykimet, është propozuar që gjyqtari të pikëzohet me një nivel më të lartë se ai që përkon me të dhënat statistikore.

Kështu duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar mund të klasifikohet si “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, dhe gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Pra nga ana ime si relatore për këtë tregues propozoj që gjyqtari të pikëzohet me nivelin maksimal të pikëve me 15 pikë.

Sa i përket treguesit “Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore”, konkretisht 2.B.a Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, referuar burimeve të vlerësimit ka rezultuar se për katër kategori çështjesh numri mesatar ka qenë 2 seanca për “krimet”, 3.5 për çështjet “familjare me palë kundërshtarë”, “civile me palë kundërshtarë” me 1 seancë gjyqësore dhe “marrëdhënie pune” 3 seanca gjyqësore. Pra numri mesatar i seancave të zhvilluara ka qenë 2.6. Saktësoj se për këtë tregues janë marrë të dhëna vetëm për dosje që janë zgjedhur me short dhe jo për të gjitha të dhënat statistikore, pasi tabelat nuk janë të qarta për sa i përket këtij treguesi.

Gjithashtu ka rezultuar se të gjitha seancat janë shtyrë për shkaqe procedurale të cilat nuk varen nga gjyqtari. Për këtë arsye referuar numrit mesatar të seancave për çdo

çështje, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri ka rezultuar 2.6 seanca dhe përgjithësisht gjyqtari ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave joproduktive. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i tij me 15 pikë.

Sa i përket treguesit 2.B.b Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtari në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për kryerjen e veprimeve paraprake, për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht në çështjet civile ashtu dhe familjare, gjykata është shprehur me vendim si për njoftimin e akteve dhe kërkesëpadisë palëve të paditura konform nenit 158 të ndryshuar të K.Pr.Civile në funksion të lëshimit të deklaratës së mbrojtjes, por njëkohësisht edhe për kalimin e çështjes në seancë përgatitore (neni 158/b i K.Pr.Civile). Por në rastet kur pala e paditur ka paraqitur deklaratë mbrojtje, nuk rezulton urdhërimi apo njoftimi i palës paditëse për këtë deklaratë mbrojtje, sipas përcaktimit të bërë në nenin 158 pika 6 të K.Pr.Civile, që parashikon detyrimin e gjykatës për të njoftuar deklaratën e mbrojtjes dhe më pas për t'i lënë kohë palës paditëse për të paraqitur pretendime lidhur me deklaratën e mbrojtjes.

Pas kryerjes së veprimeve paraprake, gjyqtari në çdo rast ka vendosur kalimin e çështjes në seancë përgatitore, duke arsyetuar se është e nevojshme për sqarimin e natyrës së mosmarrëveshjes dhe përcaktimin e provave. Kodi i Procedurës Civile, me ndryshimet e bëra me ligjin nr.38/2017 ka parashikuar mundësinë që pas kryerjes së veprimeve paraprake sipas nenit 158 të K.Pr.Civile, gjykata mund ta kalojë direkt çështjen në seancë gjyqësore (pa zhvilluar seancë përgatitore), përveç rasteve kur është e nevojshme sipas nenit 158/b, por nuk është konstatuar asnjë nga këto rastet.

Ndërsa tek dy çështjet me objekt “zgjidhje martesë”, gjyqtari ka disponuar me vendim për caktimin e seancës përgatitore pas zhvillimit të veprimeve paraprake sipas nenit 158 të K.Pr.Civile, ku në seancën e parë gjyqtari ka zhvilluar seancën e pajtimit, dhe më pas sipas nenit 158/b të K.Pr.Civile ka vendosur të kalojë çështjen në seancë

përgatitore, me të njëjtin arsytim. Pas zhvillimit të seancës përgatitore, ku palët prezent kanë dhënë shpjegime për kërkesë padinë dhe kanë listuar provat ku ata kanë mbështetur pretendimet e tyre, gjykata bazuar në nenin 158/c ka vendosur të kalojë çështjen në seancë gjyqësore, duke urdhëruar sipas rastit njoftimin e palës së paditur në mungesë dhe në një rast njoftimin e një psikologe (por urdhri apo vendimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore nuk rezulton të jetë nxjerrë i arsyetuar). Rezulton se në të dyja këto raste, gjyqtari ka vendosur marrjen e provës me ekspert në seancë gjyqësore, ku është thirrur dhe është caktuar ekspertja përkatëse, në një rast që në fillim të seancës gjyqësore dhe në një rast pasi ka vendosur të lejojë marrjen në shqyrtim të provave shkresore sipas nenit 213, ku në fakt K.Pr.Civile ka parashikuar që merret në seancë përgatitore.

Në çështjet penale, konstatohet se gjithmonë gjykata ka vënë dosjen në lëvizje sikundër parashikohet në nenin 332 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq dhe vazhdimin e gjykimit.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari jo vetëm i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën, por duke treguar edhe kujdesin maksimal për marrjen e masave për njoftimin e palëve me qëllim zhvillimin e seancave gjyqësore efektive. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj për gjykimin në shkallë të parë si në çështjet civile ashtu edhe në çështjet penale dhe seancave paraprak.

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, etj. Drejtimi i seancës zhvillohet në përgjithësi nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore. Gjithashtu rezulton që gjykata ka disponuar me vendime të ndërmjetme mbi çdo kërkesë të parashtruar nga palët në gjykim. Në dy dosje , gjyqtari shpall trupin gjykues edhe në seancë përgatitore, ku në një rast ka deklaruar edhe të hapur shqyrtimin gjyqësor sipas nenit 180/2 dhe ka vendosur të lejojë shqyrtimin e provave sipas nenit 12, 180 dhe 213 të K.Pr.Civile.

Në dosje te vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, në ndonjë rast me vonesa deri në 25 minuta me vonesë, për të cilat është relatuar shkak. Nuk ka rezultuar në asnjë rast të ketë shkuar në moszhvillimin e seancave.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë aftësie mbi mesatare në këtë tregues, evidentuar përgjithësisht në shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit të seancave përgatitore apo gjyqësore, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur përgjithësisht me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal. Nuk konstatohet i njëjti kujdes nga gjyqtari në raport me kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve procedurale sipas rregullave procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile (pas ndryshimeve), që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve paraprake dhe atyre përgatitore efektive, caktimin e ekspertit psikolog në seancë gjyqësore, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në nenin 158/b të Kodit të Procedurës Civile.

Sa më sipër, për këtë tregues është propozuar pikëzimi me 16 pikë.

Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen, konkretisht treguesi 2.C.a Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes. Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik dhe kronologjik. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi. Për këtë tregues aftësia e tij është vlerësuar shumë e lartë duke e pikëzuar me 5 pikë.

Sa i përket treguesit 2.C.b Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes. Në dosjet burim vlerësimi është konstatuar se nuk rezulton të jetë administruar kopje e letrës së të drejtave e cila i bashkëlidhet njoftimit të të pandehurit, personit nën hetim apo të dëmtuarit nga vepra penale, ndërkohë që komunikimi me shkrim i saj, bashkëlidhur njoftimit për seancën gjyqësore, parashikohet në mënyrë të shprehur në nenet 34/a, 58, 140, 137 të K.Pr.Penale. Pavarësisht se të drejtat e parashikuara nga nenet 34 dhe 58 janë respektuar, kopja nuk bashkëngjitet. Gjithashtu në dosjen civile nuk rezulton të jenë administruar dhe arsyetuar vendimi apo urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, që duhet t'i njoftohet palëve, sidomos ato në mungesë sipas përcaktimeve të nenit 158/c të K.Pr.Civile.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë mbi mesataren për këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve të që lidhen me

çështjen konkrete, përveç mungesës të letrës së të drejtave si dhe kopje e urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore sipas nenit 158/c.

Sa më sipër për këtë tregues është vlerësuar aftësia e tij mbi mesatare duke e pikëzuar me 8 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin “Aftësia organizative e gjyqtarit” është 91 pikë, niveli vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Sa i përket kriterit “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, për këtë kriter nuk janë vërejtur asnjë e dhënë që mund të ndikojë në uljen e pikëzimit pasi sipas metodologjisë së pikëzimit është prezumimi që gjyqtari ka etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale dhe vetëm në rastin kur konstatohet mungesë e tyre mund të çojë në një pikëzim tjetër. Për të gjithë këtë kriter nuk është vërejtur asnjë e dhënë që mund të çojë në një pikëzim të ndryshëm nga 100 pikë.

Për këtë arsye, po e kaloj në mënyrë të përmbledhur, pikëzimi për këtë kriter pikëzohet me 100 pikë.

Sa i përket kriterit “Aftësia profesionale dhe angazhimi profesional”, konkretisht treguesit 4.A.a Komunikimi i qartë dhe transparent, nga burimet e vlerësimit nuk rezultojnë të dhëna që mund të ndikojnë lidhur me këtë tregues, për këtë arsye është propozuar pikëzimi me 25 pikë.

Sa i përket 4.A.b Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale, edhe për këtë tregues është pikëzuar me pikët maksimale, 15 pikë, pasi nuk janë vërejtur të dhëna.

Edhe sa i përket “Aftësisë për të bashkëpunuar me kolegët por edhe me administratën, nuk janë vërejtur të dhëna negative për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit. Për këtë arsye, për të dy këto tregues është propozuar pikëzimi maksimal me 15 dhe 10 pikë.

Sa i përket treguesit “Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, 4.C.a Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale. Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit 2022 ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë

e pjesëmarrësit në 2 (dy) aktivitete të zhvilluara në 2 ditë trajnimi.

Nga materialet bashkëlidhur formularit, përcjellë me shkresën nr. {...} prot., datë 06.12.2023, protokolluar në KLGJ në datë 11.12.2023, gjyqtari subjekt vlerësimi ka përcjellë disa ftesa për pjesëmarrje në trajnime bazë, konkretisht në një workshop të zhvilluar në datën 15 dhe 17 mars dhe një ftesë për trajnimin të zhvilluar nga projekti suedez për drejtësinë penale për të mitur në datat 17 dhe 18 shkurt. Në këtë trajnim rezulton se gjyqtari është pjesë e ekipit trajnues referuar kjo edhe vërtetimit të paraqitur nga ky projekt. Gjyqtari e ka vlerësuar maksimalisht këtë tregues.

Në Metodologjinë e Vlerësimit lidhur me këtë tregues si dhe në ligjin për statusin është përcaktuar mënyra e pikëzimi. Në rast se vërtetohet se gjyqtari ka marrë pjesë në më pak se 5 trajnime gjatë një periudhe vlerësimi, pikëzohet me 4 pikë dhe në rast se është brenda periudhës së vlerësimit 5-40 ditë propozohet në nivelin maksimal.

Referuar vërtetimit të paraqitur nga Shkolla si dhe faktin që janë paraqitur dy ftesa nga ana e gjyqtarit, vlerësohen si veprimtari ndërinstytucionale nga ana ime si relatore, është propozuar pikëzimi i tij me 4 pikë, pasi rezulton të ketë marrë pjesë në dy aktivitete.

Edhe për këtë tregues gjyqtari ka paraqitur kundërshtime, të cilat do t'i parashtrojë vetë.

4.C.b Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional. Referuar burimeve të vlerësimit nuk ka rezultuar që gjyqtari të ketë udhëhequr gjatë vitit kalendarik magjistratë apo të ketë marrë pjesë si mentorues, në cilësinë e ekspertit apo lehtësuesit në Shkollën e Magjistraturës. Me vendim të Këshillit ai është caktuar si mentorues por nuk rezulton të ketë qenë mentorues gjatë periudhës së vlerësimit. Për këtë arsye, duke qenë se në Metodologjinë e Pikëzimit përcaktohet se për pikëzimin e këtij kriteri pjesëmarrja në këtë veprimtari fillon gjithmonë nga tre pikë, për gjyqtarin duke qenë se nuk rezulton që ai të ketë qenë në cilësinë e lehtësuesit apo ekspertit në aktivitetet trajnuese apo të ketë udhëhequr magjistratë gjatë vitit kalendarik, i cili është objekt vlerësimi, është propozuar pikëzimi i tij me 3 pikë.

4.C.c Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstytucionale.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton

se gjyqtari ka përcjellë shkresën e datës 20.01.2023 të Drejtorit të Njesisë për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, sipas së cilës z. {...} ka qenë i përfshirë në disa hapa të zbatimit të këtij projekti për Shqipërinë i cili është financuar nga Suedia (SIDA). Në kuadër të këtij projekti, rezulton se gjyqtari ka marrë disa ftesa për pjesëmarrje në aktivitete në Shqipëri dhe Suedi.

Në formularin e vetëdeklarimit, gjyqtari ka deklaruar se: “Si më sipër kam qenë në cilësinë e drejtuesit të projektit, në komponentin e gjykatës, në programin Suedez për të miturit në konflikt me ligjin, dhe kam dhënë kontributin tim në këtë drejtim.”.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, për këtë tregues duke qenë se rezultojnë të dhëna është propozuar pikëzimi i tij nga 3 në 5 pikë pasi rezulton angazhimi i tij.

Sa i përket 4.C.ç Publikimeve ligjore, referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, në lidhje me angazhimin e gjyqtarit në veprimtari që përfshijnë publikimet ligjore, ka rezultuar që nuk ka të dhëna të publikuara, megjithatë në formularin e vetëdeklarimit, ka deklaruar “Bashkë-Autorë i Përmbledhjes së Vendimeve Gjyqësore në fushën e Drejtësisë Penale për të Mitur nga gjykatat shqiptare 2018-2021.” Nga verifikimi në faqen e Shkollës së Magjistraturës rezulton se gjyqtari është bashkë autor në këtë libër. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi për këtë tregues me 5 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për kriterin e katërt është 82 pikë, niveli i vlerësimit "Shumë mirë”.

Propozim për nivelin e vlerësimit për çdo kriter është si më poshtë:

Aftësitë profesionale të gjyqtarit, 100 pikë.

Aftësitë organizative të gjyqtarit, 91 pikë.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë.

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, 82 pikë.

Vlerësimi i përgjithshëm është 373 pikë.

Niveli i vlerësimit, “Shumë mirë”.

Në përfundim janë përcaktuar edhe propozimet dhe rekomandime.

Unë nuk i lexova në fakt kundërshtimet e gjyqtarit duke qenë që gjyqtari është vetë sot dhe mund t'i thotë, por ju jeni të njohur të gjithë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit znj. Plaku!

Atëherë kalojmë tek magjistrati i cili shkurtimisht, pasi ne jemi vënë në dijeni mbi kundërshtimet tuaja për projektraportin, kështu shkurtimisht nëse keni ndonjë gjë plus atyre.

{...}: Faleminderit!

E nderuar zonja Kryetare e Këshillit të Lartë Gjyqësor!

Të nderuar anëtarë të Këshillit.

Unë e gjej vendin ta falënderoj relatoren për punën që ka bërë. Ndërsa jam dakord me pjesën më të madhe të vlerësimit që ka bërë, unë zgjedh të kundërshtoj një pjesë të këtij vlerësimi, të cilin shkurtimisht do ta citoj në vazhdimësi.

E para, tek treguesi 2.A.c “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” është vlerësuar me 4 pikë nga 5 të mundshme. Në raport u citua edhe arsyeja. Ndërkohë që në lidhje me këtë tregues vlerësoj se kam aftësi shumë të larta për të përfunduar çështjet në afat sipas kategorisë përkatëse në raport me standardet minimale kohore të miratuara për çdo kategori. Sjell në vëmendje që ngarkesa ka qenë jashtëzakonisht e lartë provuar kjo nga statistikat e depozituara dhe me 571 (pesëqind e shtatëdhjetë e një) vendime të dhëna nga ana ime si gjyqtar, nga 706 çështje të shortuara gjatë vitit 2022. Nga data 27.01.2022 e në vijim përveç detyrës së gjyqtarit, kam ushtruar edhe detyrën e Zv/Kryetarit të gjykatës me kompetenca të plota të Kryetarit. Gjatë vitit 2022, për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar, delegimeve apo të gjyqtarëve me leje lindje, gjykata në pjesën më të madhe nga 17 gjyqtarë që ka pasur organika e plotë, ka funksionuar me vetëm 6 gjyqtarë, duke përfshirë edhe Zv/Kryetarin e gjykatës. Në këto 6 gjyqtarë përveç shortit ditor, janë shpërndarë edhe dosjet e gjyqtarëve të tjerë, duke e rritur në mënyrë të menjëhershme ngarkesën. Kjo me patjetër ka kërkuar kohë për studimin e dosjes, planifikimin dhe përfundimin e saj. Në muajin korrik të vitit 2022, jemi përballur edhe me grevën e

Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe shtoj këtu edhe faktin që përveçse kam qenë një 100% në short gjatë gjithë vitit së bashku me 5 gjyqtarët e tjerë, kam qenë pjesë e gatishmërisë çdo muaj, përfshirë edhe muajin gusht të vitit 2022.

Përveç detyrës së gjyqtarit thashë kam pasur edhe detyrën e Zv/Kryetarit e cila ka kërkuar impenjim dhe kohë. Dua të shtoj edhe diçka tjetër që përveç 571 vendimeve që kam dhënë në vitin 2022 kam edhe 216 kërkesa të gjyqtarëve për heqje dorë të nga dosjet, për të cilat janë shprehur në vendim. Kështu që në këtë pikë vlerësoj që vlerësimi në këtë rast duhet të jetë jo me 4 pikë por me 5 pikë.

Nga Projekt-Raporti, rezulton se treguesi 2.A.ç “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” është vlerësuar me 8 pikë nga 10 pikë të mundshme. Nuk dua të bie në përsëritje të atyre çfarë thashë më lart, por dua t’i referohem Metodologjisë së Pikëzimit ku në pikën 1.1. të saj thuhet ndër të tjera se: “...të cilat mund të çojnë në pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzimin maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli”. Është e dukshme se këto standarde jo vetëm që janë arritur nga ana ime, por që janë tejkaluar me 64.5%, ndaj kërkoj që edhe vlerësimi në këtë rast të bëhet maksimalisht me 10 pikë, pra duke mos rënë në përsëritje të atyre që u thanë më lart.

Tek treguesi 2.B.b “Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, edhe në lidhje me këtë tregues vlerësoj se ka shkallë të lartë aftësie pasi mendoj se njoh shumë mirë rregullat procedurale të parashikuara si në K.Pr.Civile ashtu edhe në K.Pr.Penale.

Në lidhje me dosjet gjyqësore që janë marrë në analizë në projektraport (dy çështje familjare) janë zhvilluar në zyrën e gjyqtarit, për shkak të mungesave të sallave të gjykimit. Me të drejtë, në projektraport janë evidentuar parregullsi, të cilat të jem i sinqertë nuk është se kanë ardhur për shkakun tim, por të administrimit të çështjes dhe nga sekretaria gjyqësore. E them këtë pasi situata të tilla nuk përsëriten në praktikën time të punës sime, nëse një çështje do të zhvillohet në zyrë, në sallë me regjistrim audio. Mendoj se anën procedurale e kam të qartë, pjesën e fillimit dhe mbarimit të një procesi gjyqësor. Urdhri për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, në vlerësimin tim, nuk duhet

të formalizohet me shkrim, por duhet të pasqyrohet në procesverbalin e seancës gjyqësore. Ndaj kam vlerësuar dhe të po të shikojmë të gjitha çështjet civile që kam gjykuar, është i njëjti model të vepruari. Në lidhje me caktimin e ekspertit, vendimin e marr në seancë përgatitore. Kështu e lexoj ligjin procedural civil. E marr si vendim, pasi marr edhe konfirmimin e palëve dhe detyrat i jap në seancë gjyqësore, pasi hapi hetimi gjyqësor, palët parashirojnë pretendimet që kanë dhe aty është momenti që procedohet me marrjen e detyrave ekspertit.

Gjithsesi dua të bëj me dije Këshillin se dy çështjet që janë marrë në analizë janë çështje që kanë marrë formë të prerë dhe nuk janë konstatuar si problematikë. Kështu që edhe në këtë rast, për këtë tregues vlerësoj se shkalla e aftësisë të vlerësohet më e lartë duke u pikëzuar me 20 pikë.

Sa i përket treguesit tjetër 2.C.b “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit” është vlerësuar me 8 pikë nga 10 pikë të mundshme. Është konstatuar mungesa e letrës së të drejtave në procesin penal dhe mungesa e arsytimit të vendimit për kalimin e çështjes nga seancë përgatitore në seancë gjyqësore.

Që me ndryshimet e K.Pr.Penale, në vitin 2017, nga ana ime është treguar kujdes i veçantë komunikimi i letrës së të drejtave të pandehurit dhe viktimës së veprës penale. Mënyra se si kam proceduar dhe procedoj është që të pandehurit por edhe viktimës së veprës penale letrën e të drejtave e nis së bashku me fletëthirrjen. Nëse konfirmohet do të thotë që i pandehuri, viktimën ka marrë dijeni për letrën e të drejtave dhe nëse nuk konfirmohet, kthehet bashkë me fletëthirrjen dhe bëhet pjesë e dosjes gjyqësore. Për më tepër letra e të drejtave është komunikuar që në hetimet paraprake, dhe gjykata kur administron dosjen është e tillë që konstaton që i pandehuri është njohur me letrën e të drejtave sepse nëse nuk është njohur dhe ka pengesa të tilla, ligji parashikon që t’i kthehet dosja prokurorit dhe të vazhdojë të bëjë veprime të tjera procedurale, qoftë edhe komunikimin e letrave të të drejtave.

Në lidhje me vendimin për kalimin e çështjes në seancë nga përgatitore në seancë gjyqësore, praktika është e tillë që e arsyetoj dhe them në procesverbal dhe jam mjaftuar me këtë lloj mekanizmi.

Kështu që duke menduar se kam përmbushur në mënyrë të plotë detyrimet ligjore,

kërkoj pikëzimin maksimal edhe në këtë komponent, me 10 pikë.

Në projektraport rezulton tek treguesi 4.C.a “Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”, se jam vlerësuar me 4 pikë nga 16 pikë të mundshme sikurse parashikohet.

Ju bëj me dije se kam përmbushur këtë detyrim për të marrë pjesë në trajnime vazhduese pranë Shkollës së Magjistraturës. Pasi kam ardhur në dijëni të projektraportit të përgatitur, që më është komunikuar më datë 17 janar 2024, i jam drejtuar me shkresë Shkollës së Magjistraturës, duke i kërkuar informacion në lidhje me seminarët që kam zhvilluar. Me shkresën nr. {...} prot, datë 23.01.2024 Shkolla e Magjistraturës më ka kthyer përgjigje si vijon: “...pas verifikimeve të bëra nga Sektori i Formimit Vazhdues, vërtetojmë se gjatë vitit 2022 keni marrë pjesë në aktivitete trajnuese të zhvilluara nga Projekti Suedez (Sida) në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës në datat 14-17 mars 2022 dhe 20 maj 2022”, që së bashku me vërtetim tjetër të paraqitur më parë gjatë vlerësimit plotësohet 5-ditorshi si detyrim nga ana ime për të ndjekur programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës. Kështu që edhe në këtë rast, pikëzimi sipas vlerësimit tim duhet të jetë jo me 4 pikë por me 20 pikë.

Vërtetimin e kam nisur të skanuar, së bashku me kundërshtimet pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Nga Projekt-Raporti, rezulton se treguesi 4.C.n “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatet për gjyqtar gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, jam vlerësuar me 3 pikë nga 5 pikë të mundshme.

Në lidhje me këtë tregues, vlerësoj se e kam qenë i disponueshëm, por për arsye që nuk varen nga unë nuk jam angazhuar. Me vendim të KLGJ-së në vitin 2022 jam caktuar si gjyqtar mentorues për trajnimin e magjistratëve. Në gjykatën ku unë ushtroj detyrën, deri në këto momente nuk ka pasur gjyqtar stazhier. Nga ana tjetër, sipas vërtetimit nr. {...} prot, datë 23.01.2024, Shkolla e Magjistraturës ka konfirmuar se me vendimin nr. {...}, datë 27.09.2022 “Për miratimin e kalendarit të aktiviteteve trajnuese në Programin e Formimit Vazhdues për vitin akademik 2022-2023”, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtari {...} është miratuar në cilësinë e lehtësuesit në Programin e Formimit Vazhdues. Sjell në vëmendje të Këshillit të Lartë Gjyqësor se për

vitin 2022 nuk jam thirrur nga Shkolla e Magjistraturës në cilësinë e lehtësuesit dhe kjo nuk ka ardhur për shkaqe që vareshin nga vullneti im. Ndërkohë, për vitet 2021 kam marrë pjesë si lehtësues në Shkollën e Magjistraturës dhe e kam provuar këtë fakt, ndërkohë që kam marrë pjesë edhe në vitin 2023 po si ekspert në këtë rast pranë Shkollës së Magjistraturës.

Sjell në vëmendje të Këshillit gjithashtu se unë kam qenë pjesë e programit Suedez për të miturit në konflikt me ligjin nga viti 2018 si pjesëmarrës dhe nga viti 2019 deri në vitin 2022 në cilësinë e drejtuesit të projektit. Në kuadër të këtij projekti edhe në vitin 2022 ne kemi zhvilluar seminare dhe unë i kam nisur me e-mail, në kushtet që s'e provoj dot nga ana tjetër, angazhimin tim që kam pasur si ekspert edhe në vitin 2022 dhe kur është bërë seminari, kanë qenë të pranishëm gjyqtarë, prokurorë dhe aktorë të tjerë të drejtësisë. Pra unë pavarësisht ngarkesës së madhe që kam pasur në vitin 2022, me gjithë ato çfarë thashë më lart, nuk kam lënë pa ndjekur asgjë tjetër nga komponentët e vlerësimit që ka bërë KLGJ-ja, pra mendoj se kam qenë një gjyqtar aktiv, pavarësisht ngarkesës së madhe që kam kaluar.

Dua të shtoj në këtë rast edhe faktin që në gjykatë, është bërë traditë prej disa vitesh që vijnë prania e studentëve të Fakultetit të Drejtësisë, të Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës, dhe gjyqtari, jo vetëm unë por edhe gjyqtarët e tjerë që janë aty, përveç lejitimit në sallë për të marrë pjesë, konsultimit në konsulenca të caktuara që mund t'u jepet, pra është një mënyrë kohe e harxhuar edhe me studentët, prandaj e kemi si traditë dhe vazhdon akoma, përfshirë edhe rastin tim.

Kështu që pas këtij parashtrimi, vlerësoj dhe kërkoj nga ana e Këshillit të Lartë Gjyqësor një vlerësim maksimal sepse vërtet e mendoj që e kam meritë në këtë rast.

Dua të shtoj edhe diçka tjetër që është e fundit, ndaj e kam marrë edhe këtë pjesën për të ardhur këtu përpara Këshillit, unë detyrën e gjyqtarit nuk e shikoj thjesht si funksion, e kam parë si mision që unë përpiqem ta përmbush dita-ditës. Unë marrë kohë nga gjërat e tjera familjare për t'i qëndruar në kokë kësaj pune dhe mendoj që kam arritur një nivel të caktuar; dhe për shumë gjëra që kam kaluar është kjo pjesa që kërkoj përfundimisht të vlerësohem në mënyrë të "Shkëlqyeshme" në këtë rast.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Naureda Llagami: Shumë faleminderit z. {...} për prezantimin e kundërshtimeve. Do ju ftoja që ju të largoheni për të lejuar Këshillin.

Kemi pyetje?

Po!

Irena Plaku: Një pyetje nga ana ime.

Së bashku me raportin e vetëvlerësimit keni sjellë edhe disa ftesa në pjesëmarrje në këto veprimtari. Ku konsistonin këto veprimtari? Mund të ma shpjegoni pak të lutem? Domethënë këto seminare? Çfarë ishin domethënë? Si funksiononte? Çfarë detyrash kishit? Çfarë bënit në këto seminare?

{...}: Faleminderit!

Jua thashë edhe në fillim, sepse nuk e provoj dot, se Shkolla e Magjistraturës nuk paguante ekspertë dhe lehtësues në këtë rast kur merrnin pjesë. Unë s'jam paguar nga Shkolla e Magjistraturës dhe Programi Suedez nuk i paguante ekspertët shqiptarë. Nuk jam vetëm unë ekspert atje, kanë qenë edhe drejtues të tjerë të gjykatave (Tirana dhe Durrësi ka qenë) dhe nuk jemi paguar.

Irena Plaku: Dhënia e kontributit nuk është gjithmonë me pagesë. Kontributet të cilat vlerësohen nga Këshilli nuk kërkohet, referuar rregullores, nuk kërkohet për pagesë. Nuk flas për pagesë, që ta dini këtë gjë.

{...}: Kërkoj ndjesë (*e përsërit disa herë*).

E kisha në pjesën që magjistratura e ka të vështirë ta thotë këtë gjënë e saj sot.

Ku konsistonte? Ne ishim një grup drejtuesish projekti, përfshirë edhe suedezë (nga Shqipëria isha unë në Durrës dhe dikush tjetër në Tiranë). Ne kishim planifikuar seminare. Kemi zhvilluar seminare në Vlorë, janë zhvilluar seminare në Pogradec, janë zhvilluar në Durrës, janë zhvilluar në Tiranë, dhe unë në një pjesë të tyre kam qenë ekspert, dhe në tema të caktuara për drejtësinë penale për të miturit (ishte e fokusuar

gjëja).

Irena Plaku: Unë e kuptoj, sepse i kam parë ftesat, nuk është se s'i kam parë me pak fjalë. Po pyes, çfarë pune kishte ky grupi që ishit mbledhur juve me pak fjalë? Sepse ju ishit një grup pune që në përfundim (të paktën si e kam parë unë) keni shkuar në botimin e një manuali apo disa vendimeve gjyqësore, një libri përmbledhje. Të paktën siç e kam parë unë, referuar burimeve të vlerësimit dhe vërtetimit të lëshuar nga drejtuesi i këtij projekti Suedez. Unë nga ajo jam referuar. Nuk është se i jam referuar ndonjë gjëje tjetër. Po them tek ajo që jam referuar unë. Kështu e kam kuptuar. Mund të ma shpjegosh pak çfarë është ndryshe me pak fjalë? Sepse unë e kam parë si një grup pune, diskutimesh, që jeni mbledhur disa herë në fakt referuar këtyre ftesave, edhe në Suedi.

{...}: Funksiononte i tillë projekti, sepse ne zhvillanim seminare në cilësinë e ekspertit lehtësues dhe zhvillanim edhe takime, si drejtues projekti të gjithë bashkë. Të gjitha ato problematika që dilnin kemi arritur në konkluzionin siç kemi bërë edhe pjesën e botimit. Ndërkohë që seminarët kanë qenë tipike seminare që zhvilloheshin rajonale për të trajnuar gjyqtarë dhe prokurorë, duke filluar unë në këtë rast përgatitja materialin për temën e caktuar, merrja kohën e mjaftueshme në "Powerpoint" me material të shkruar, me praktikë të Gjykatës së Lartë (*nuk kuptohet fjala*) qenë në atë kohë se s'ka pas shumë çështje, dhe shkoja bëja prezantimin. Materialet e mia shpërndareshin edhe tek pjesëmarrësit që ishin aty, pra ka qenë e ndarë gjëja.

Naureda Llagami: Sa kujtoj unë në fakt këtë projektin që më ka ardhur më ka takuar, qëllimi i këtij projekti në fakt ishte, me dalje e kodit të të miturve, ishte për caktimin e një grupi pilot gjyqtarësh që do ishin trajnerë për gjyqtarët e tjerë që do caktoheshin në seksionet e të miturve. Kemi pasur një komunikim, unë si Kryetarja e KLGJ-së, bashkë me projektin, dhe emrat e personave që ishin zgjedhur si trajnues, që kishin marrë edhe një formim të specializuar nga ekspertët e projektit por një formim të specializuar duke parë edhe nga kolegët e vet në Suedi. Qëllimi që kishte projekti për vijimësinë e punës ishte që këto grupe që trajnoheshin do trajnonin gjyqtarët e tjerë që do

ishin në seksion dhe qëllimi i projektit ishte që të kishte edhe kurrikulën më pas Shkolla e Magjistraturës për një formim vazhdues për sa i përket. Kjo ishte përzgjedhja, dhe me sa mbaj mend ka qenë një përzgjedhje diku kryetarë gjykatash, diku jo kryetarë gjykatash, por që i kishte përzgjedhur projekti vetë për të qenë në vijimësi të formimit vazhdues.

Për shkak të projektit, në si KLGJ ndryshuam, duke qenë se nuk kishim në seksione për të mitur, ne kemi marrë parasysh në një nga vendimet tona, ku kemi thënë që pavarësisht se nuk kemi seksione për të mitur pra nuk kishim gjyqtarë të trajnuar, por minimumi kemi thënë ato gjyqtarë që mund ta kenë ndjekur këtë formimin që kishte bërë projekti. Këtë kemi reflektuar ne kur na është kërkuar nga projekti që ne të kishim një seksion për të mitur. Por ne për shkak të numrave të kufizuara kemi thënë që të jenë gjyqtarët që kanë ndjekur një trajnim. Kjo ka qenë logjika e projektit. Unë në fakt kam edhe komunikime me projektin që më ka ardhur dhe më ka takuar pikërisht për vijimësinë. Në momenti që është krijuar KLGJ-ja, ka qenë në fillime dhe më pas kemi pasur vijueshmëri.

Fatmira Luli: Mund të pyes edhe unë, sa ditë bëhen? Janë të fiksuara datat e këtyre trajnimeve që ju keni bërë në tërë Shqipërinë? Këto data, sa përfshijnë në tre vjet, këto aktivitetet që keni bërë ju bashkë me këtë trajnimin 5-ditor që pretendoni? Sa është sasia e ditëve që ju keni marrë pjesë në tre vjet në trajnim?

{...}: Kërkoj ndjesë, sepse nuk i kam datat, nuk i kam me një numër të caktuar fikse numri i seminareve që kemi zhvilluar. Nuk e kam njësi fikse. Por ne kemi zhvilluar takime periodike si drejtues grupi pastaj kemi zhvilluar edhe seminare, qoftë në Tiranë, qoftë edhe rajonale nëpër qytete të caktuara. I kam depozituar një pjesë të ftesave.

Unë kam evidentuar tre deri tani, sepse kam parë të mjaftueshme për ta kaluar.

E-maillet që kam nisur, ka edhe logon e Shkollës së Magjistraturës. Edhe vërtetimi që është lëshuar është bërë pasi janë bërë verifikimet.

Naureda Llagami: Shkolla zhvillon aktivitete së bashku me projektet. Ka projektet që i mbulon vetëm shkolla, ka aktivitete të tjera ku ajo vazhdon me partnerë të

tjerë, sepse vijnë ekspertë vendas dhe të huaj për çështje të caktuara. Rasti konkret ky ka qenë. Kemi pas marrëdhënie edhe në Këshill me Suedezët dhe ne kemi pas përfaqësues edhe në projektin që kanë zhvilluar dhe ku keni qenë edhe ju pjesëmarrës në këtë lloj projekti.

Kemi diskutime të tjera, pyetje?

Jo!

Shumë faleminderit!

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtari {...}.)

Naureda Llagami: Nga ana e relatores.

Irena Plaku: Atëherë, për sa i përket kundërshtimeve të paraqitura nga ana e gjyqtarit, sa i përket konkretisht treguesit “Aftësia organizative” unë i qëndroj të gjithë vlerësimit që kam bërë në projektraport, për shkak se janë marrë parasysh të gjitha ato që deklaroi gjyqtari, konkretisht ngarkesën e tij, aktiviteti i tij si zëvendëskryetar, të cilat kanë çuar më pas në një rritje niveli nga 1 deri në 3 nivele. Po të shikohet në projektraport, tek rendimenti është rritur 4 nivele sepse është konsideruar që diferenca ishte shumë e vogël dhe janë rritur nga 2 në 8 pikë (nivelet 2, 4, 6, 8), kështu që janë rritur katër nivele. Domethënë unë mendoj që i kam marrë parasysh të gjitha këto për këtë tregues të cilat kanë shkuar në atë pikëzim.

Për sa i përket “Kryerjes së veprimeve të nevojshme” për të cilën gjyqtari pretendoi që kështu e zbaton Kodin e Procedurës Civile apo procesverbali ka qenë nga sekretaria gjyqësore. Nuk e di se si është procesverbali. Procesverbali vërtetë është mbajtur jashtë seancës gjyqësore por është nënshkruar nga gjyqtari, çka do të thotë që gjyqtari e ka nënshkruar faqe më faqe atë procesverbal, mban përgjegjësi, aq më tepër kur është nënshkruar nga ana e gjyqtarit dhe unë atij i referohem, nuk kam se kujt t’i referohem tjetër.

Edhe sa i përket letrës së të drejtave, ne e kemi mbajtur një standard që mungesa e letrës së të drejtave nuk do të thotë që nuk i ka respektuar të drejtat por nuk është

administruar dhe pikërisht janë ulur pikët tek mosadministrimi.

Edhe sa i përket vendimit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Vendimi i kalimit në seancë gjyqësore, me ndryshimet e K.Pr.Civile. që ka hyrë në fuqi në 2017, ka parashikuar detyrimin që urdhri për kalimin e seancës gjyqësore duhet t'i njoftohet, çka nënkupton që duhet të jetë e administruar edhe një kopje duhet t'i dërgohet palës. Nuk ka qenë e arsyetuar sepse vetë gjyqtari e pranoi, nuk ishte në dosje, nuk ishte administruar dhe nuk i është njoftuar palëve konform detyrimit që ka gjyqtari për t'i njoftuar, aq më tepër se nuk bëhet fjalë për rastet kur palët janë në prezencë sepse prezumohet që janë njohur me vendimin e kalimit, por kanë qenë raste kur palët kanë qenë në mungesë dhe me vendimin e kalimit gjyqtari duhet të njoftojë edhe vendimin, momentin procedural ku ndodhet çështja sepse parashikohet në Kodin e Procedurës Civile, jo se e them unë me pak fjalë. Para ndryshimeve nuk ishte e domosdoshme për sa kohë që nuk parashikohej detyrim.

Një ndër faktet që i është ulur pikëzimi është edhe fakti se nuk i është njoftuar, kur paraqet pala e paditur deklaratën e mbrojtjes, konform nenit 158, pika 6, parashikohet detyrimi i gjykatës për t'i njoftuar deklaratën e mbrojtjes së paraqitur nga pala paditëse palës paditëse e cila duhet të mbajë qëndrimin lidhur me këtë. Kështu që unë i qëndroj pikëzimit për sa i përket kriterit "Aftësia organizative".

Sa i përket kriterit të katërt "Angazhimi ndaj vlerave profesionale", gjyqtari për sa i përket numrit të seminareve, ka rezultuar referuar kjo vërtetimit të paraqitur nga Shkolla e Magjistraturës, ka marrë pjesë në dy trajnime, të cilat janë cituar edhe nga ana e gjyqtarit nuk u kundërshtuan në këtë fakt.

Ishin paraqitur edhe disa kërkesa, ftesa në fakt në cilësinë e provës, të cilat ishin pjesëmarrës në projektin Suedez, të cilat unë i kam kualifikuar referuar dhe burimeve të vlerësimit dhe vërtetimit të lëshuar nga drejtori i njesisë për marrëdhënie ndërkombëtare i këtij programi ka rezultuar se ka qenë në cilësinë e ekspertit në këtë program. Ekspert në këtë program konsiderohet si veprimtari ndërinstitucionale, referuar kjo rregullores, metodologjisë së pikëzimit. Për këtë arsye është kualifikuar si e tillë.

Gjithashtu në vlerësimin për këtë tregues kam mbajtur parasysh edhe faktin se kemi vlerësuar edhe një gjyqtar tjetër që ka ushtruar të njëjtën veprimtari dhe nuk i janë

quajtur këto seminare si pjesëmarrje në seminare. Për këtë arsye unë duk iu referuar edhe praktikës, e kam vlerësuar në këtë pikëzim. Nga ana e gjyqtarit më pas është paraqitur ky vërtetimi i Shkollës së Magjistraturës që u citua dhe ju jeni njohur, vërtetim të cilin Shkolla e Magjistraturës vetë e ka paraqitur, se ne i kërkojmë informacion Shkollës së Magjistraturës sa herë që bëjmë vlerësimin e gjyqtarëve dhe ka paraqitur konkretisht vetëm 2 seminare dhe nuk janë këto seminare, që më pas gjyqtari i ka drejtuar kërkesë dhe është përgjigjur. Pra në këtë vlerësim ne kemi dy vërtetime të lëshuara nga Shkolla e Magjistraturës të cilat nuk janë të njëjtat të dhëna me pak fjalë, pavarësisht se janë paraqitur në kohë të ndryshme. Unë këtu kam edhe një diskutim, në rast se a duhet t'i drejtohem edhe një herë Shkollës së Magjistraturës për të na saktësuar kush është vërtet pjesëmarrja e gjyqtarit në këto trajnime. Vërtet që në rregullore është parashikuar që nuk duhet të jenë vetëm trajnime nga Shkolla e Magjistraturës, për trajnime domethënë, që të ketë marrë pjesë në këto trajnime. Për këto arsye është vlerësuar në këtë rast.

Për sa i përket pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese apo në cilësinë e lehtësuesit, nga vërtetimi i Shkollës së Magjistraturës ka rezultuar se nuk ka marrë pjesë. Është e vërtetë që është miratuar në fakt si lehtësues por nuk ka marrë pjesë. Dhe ne kemi praktikë që nuk vlerësohet fakti që ti je në listën e pritjes, por vlerësohet pikërisht aktiviteti, kontributi që ke dhënë efektivisht sepse kemi pasur edhe gjyqtarë të cilët janë përcaktuar në listën e udhëheqësit por nuk janë vlerësuar për sa kohë që nuk kanë pasur magjistratë për të udhëhequr gjatë periudhës së vlerësimit.

Sa i përket pretendimit të gjyqtarit në lidhje me faktin që kanë qenë studentë të universitetit në Durrës, ne nuk e kemi pasur një vërtetim të tillë, por edhe në rast kur kemi pasur gjyqtari është vlerësuar maksimalisht për sa i përket veprimtarisë ndërinstitucionale. Domethënë aktiviteti i gjyqtarit në trajnimin e studentëve apo dhënien e mësimit konsiderohet/klasifikohet si veprimtari ndërinstitucionale dhe për këtë pikë ne nuk e kemi pasur si vërtetim, se në rast se do e kisha, do e thoja që ka edhe këtë veprimtari ndërinstitucionale. Por në fakt ai për këtë tregues është pikëzuar maksimalisht.

Kështu që unë në fakt e kam diskutim sa i përket trajnimeve vazhduese, në rast se ju do e vlerësoni që duhet t'i drejtohem edhe një herë Shkollës ose jo, domethënë është qëndrimi juaj.

Naureda Llagami: Ne kemi pas edhe herë të tjera dhe s'i kemi drejtuar Shkollës?
Kemi pas edhe herë të tjera që ka sjellë Shkolla dy herë, tre herë për një kandidat.
Ti personalisht jo, por Komisioni ka pas.

Irena Plaku: Sa kam qenë unë dy vjet.
Është e njëjta. Të njëjtin vërtetim. Ka qenë grupi drejtues, siç ka qenë {...}. Është e njëjta (i drejtohet një anëtar.)

Markelian Koça: Kjo ndodh zakonisht kur nuk janë aktivitete ekskluzivisht të Shkollës, por ka edhe partnerë të huaj, sepse varet nga mënyra si identifikohet dhe si pasqyrohet pjesëmarrja.

Irena Plaku: Në fakt flas për vete se nuk e di se çfarë është bërë nga Këshilli.
Sa kohë që kam qenë unë të paktën pjesëmarrëse, për të gjitha që kam pasur në cilësinë e relatores apo kam qenë prezent, jam vënë në dijeni nga anëtarët e Komisionit, nuk kemi pasur një rast të tillë. Unë të paktën kam dy vjet e pak këtu. Nuk i mbaj mend të gjitha. Kam verifikuar në fakt raportet e tjera të cilat kanë qenë në e-mail për të parë të njëjtat standarde, por me aq sa kam unë dijeni nuk kemi drejtuar. Unë e ngrita si diskutim në fakt. Kështu që është vlerësimi i anëtarëve të Këshillit.

Naureda Llagami: Unë mbaj mend, të paktën tek aktet që kam parë nëpër vlerësime që kemi pas jo një por dy të sjella në raport këtu për plenare, një ose dy vërtetime nga Shkolla. Një herë Shkolla ka thënë nuk ka pasur, ndoshta pastaj më vonë Shkolla ka thënë.. Këtë mbaj mend unë nga aktet e mia, pa mbajtur mend emra. Tani ky është një problem dhe pastaj kur e ka sjellë të dytin, e keni vlerësuar dhe ia keni shtuar pikët vetë ju si relator. Nuk e di tani kush ka qenë, e jotja, e Yllkës, e {...}, {...}, se s'e mbaj mend këtë gjë. Pra vetë ju keni reflektuar për ta bërë. Ai na e solli në mbledhje plenare.

Tani, unë besoj që kemi një vërtetim të Shkollës. I hyjmë dot neve vërtetësisë së

asaj që na thotë Shkolla? Pastaj ne kemi dhënë opsion që të gjithë kandidatët deri në minutë të fundit këtu na kanë sjellë letra, na kanë sjellë letra nga kancelarët, na kanë sjellë letra nga universitetet, na kanë sjellë letra nga të gjithë. Kështu që, në qoftë se ne do mbajmë këtë standard kështu, atëherë i bie që ne të kthehemi mbrapsht të gjithë dhe të shkojmë tek standardet pse kemi pranuar të tjerët. Për sa kohë vërtetimi i Shkollës është i drejtë dhe është i saktë, në qoftë se ne nuk kemi dyshime, atëherë unë them që duhet të vazhdojmë. Nëse ne do bëjmë një diskutim tani që neve do marrim të kërkojmë për të disatën herë, dhe kjo është pjesë e vlerësimit. Thjesht po ju sjell në vëmendje që kemi pasur raste kur vetë relatorët kanë marrë të administruar nëpër dosje një, dy, tre vërtetime nga i njëjti institucion. Kështu që këtë pjesë hajde ta vlerësojmë këtu, në qoftë se keni diskutime mbi vërtetimin e Shkollës.

Markelian Koça: Përgjegjësinë e mban ai që lëshon vërtetimin. Por duhet ndoshta, jo me një gjë konkrete pra që ne ta shtyjmë dhe të verifikojmë këtë gjënë, duhet t'i tërhiqet vëmendja shkollës sepse këto janë problematika, ju e dini shumë mirë që ne kemi në proces shumë gjyqtarë për vlerësim, nuk është serioze që një institucion i tillë sjell dy përgjigje të ndryshme.

Naureda Llagami: Irena, do i rrimë këtij diskutimi?

Po! Neve nuk i hyjmë përgjegjësisë që ka institucioni tjetër.

Po! Atëherë, në kushtet që ti reflekton tek pikëzimi?

A e ndryshon pikën kjo në qoftë se merret në konsideratë?

Irena Plaku: Në rast se këto do të konsiderohen trajnime, referuar vërtetimit, normalisht ndryshon pikëzimi, sepse do shkojë pikëzimi tashmë nga 4 në 20, referuar metodologjisë së pikëzimit, sepse në rast se do të konsiderohen trajnime, megjithëse thashë nuk janë konsideruar trajnime për ato arsye të cilat unë i thashë, ndër të tjera nuk kishte asnjë vërtetim Shkolla, por nuk mjafton vetëm vërtetimi i Shkollës për të treguar që kemi apo jo pjesëmarrje në trajnim, sepse rregullorja parashikon trajnim pranë Shkollës apo institucioneve të tjera. Unë nuk i kam konsideruar trajnime, jo vetëm që

kisha vetëm ftesën, por edhe nga përmbajtja e vërtetimit të lëshuar nga drejtuesi i projektit, e cila për mua nuk ka qenë në kuadër të trajnimeve por ka qenë grup pune, grup pune i cili ka përfunduar më pas në atë punim. Kështu që unë nuk e di nëse do jenë trajnime apo jo. Po t'i referohemi vetëm vërtetimit...

Naureda Llagami: Irena, letrën që na ka sjellë Shkolla.

Irena Plaku: Po t'i referohemi trajnimit, do të shkojë në 20 pikë. Gjithsesi është përsëri në vlerësimin tuaj.

Naureda Llagami: Ti si relatore tashmë që je vënë në fakt me letrën e Shkollës, propozon që të shkojmë në 20 pikë, duke e marrë të mirëqenë atë që na ka thënë Shkolla. Ok!

Tjetër diskutim?

Po!

Markelian Koça: Në fakt, duke kërkuar ndjesë se nuk e di praktikën tuaj të më përparshme, unë dua ta them që për pikën e fundit “Disponueshmëria për të qenë udhëheqës, etj.” pra angazhime nga Shkolla, në fakt kjo nuk lidhet me vullnetin e gjyqtarit, është përfshirë, ka dhënë vullnetin për të qenë pjesë. Është Këshilli i Shkollës që vendos ku do jesh lehtësues, ku do jesh ekspert. Ju thashë ndoshta ju keni mbajtur qëndrim për këtë gjë por nuk është vullneti i gjyqtarit për të mos qenë. Gjyqtari ka thënë... sepse ne kur plotësojmë, siç plotësojmë aktivitetet për temat, plotësojmë edhe një formular ku shprehim dëshirën për të qenë ekspert, lehtësues, sipas vjetërsisë. Që do të thotë, derisa e kam 2021, 2023 edhe mund të kërkohet, por prezumohet që ka qenë, ka bërë kërkesë. Fakti që s'e ka përfshirë Shkolla, pse duhet ta penalizojë magjistrati?

Yllka Rupa: Prandaj fillon vlerësimi me 3 pikë.

Irena Plaku: Referuar metodologjisë vlerësohet vetëm angazhimi i gjyqtarit dhe

jo gatishmëria. Gatishmëria në fakt vlerësohet me 3 pikë. Nuk fillon nga 0. Meqenëse nuk është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, fillon pikëzimi me 3 pikë, automatikisht domethënë.

Naureda Llagami: Kemi diskutime të tjera?

Fatmira Luli: Unë gjykoj që duhet parë edhe rendimenti sepse shoh që numri i çështjeve që ka gjykuar është shumë i madh, është 571 çështje nga 706 caktuar. Fakti që ka qenë edhe kryetar, ne kemi vepruar edhe në raste të tjera, i kemi rritur disa nivele. Kështu që ai ka tejkaluar edhe standardin, ka gjykuar më shumë se 64.5% të çështjeve dhe gjykoj që duhet të marri vlerësim maksimal. 2Aç, nga 8 të marri 10.

Naureda Llagami: Irena, ke ndonjë koment për këtë?

Irena Plaku: Siç e thashë unë i qëndroj vlerësimit për sa kohë që unë e kam rritur me aq nivele sa cituam në projektraport. Por duke pasur parasysh dhe standardet që kemi vlerësuar dhe gjyqtarët e tjerë nuk kanë arritur në këtë nivel vlerësimi, nga niveli 2 deri në 10 pikë, unë mendoj se duhet të jemi 8 pikë. Pse? Sepse kemi pasur gjyqtarë të cilët kanë pasur një rendiment shumë më të lartë dhe i është rritur një nivel, por nuk mund të barazohet një gjyqtar që ka 96 % rendimentin me një gjyqtar që e ka 80 % rendimentin, të paktën në pikëzim. Po pra, 87% pikëzohet me 2 pikë dhe nga 2 pikë ka shkuar, llogarite niveli i dytë pas 2 pikëve është 4, niveli i tretë pas 2 pikëve është 6. Unë këtë po them.

Zonja Luli paraprakisht flet pa mikrofonin ndezur...

Fatmira Luli: ... kështu që unë gjykoj që ndodhemi në rastin që me aq shumë çështje sa ka gjykuar dhe me faktin që ka qenë edhe kryetar gjykate duhet t'i ngrihet dhe niveli t'i shkojë në nivel maksimal.

Naureda Llagami: 100% ka qenë kryetar? Nuk ka bërë ulje?

Markelian Koça: Ka punuar 100% dhe ka qenë edhe gjyqtar i gatshëm që zakonisht për shkak të problematikave, zëvendëskryetarët ose titullarët nuk kanë hyrë. Meqenëse numri shkoi në gjashtë dhe ishte një ngarkesë e papërballueshme, ka qenë edhe gjyqtar i gatshëm për gjatë gjithë vitit.

Naureda Llagami: Meqenëse s’kemi dhe kemi vetëm dy sugjerime, tre me gjithë të Kelit, por Keli ne e kemi mbajtur si standard me thënë të vërtetën. Dy janë: një që e pranon vetë relatorja për punën e Shkollës së Magjistraturës. Votojmë këtë njëherë?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet unanimisht.)

Naureda Llagami: Atëherë kemi edhe propozimin e Fatmirës, e cila thotë nga 8 në 10 për rendimentin.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Kundër.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet me shumicë votash.)

Naureda Llagami: Në total kemi 391 pikë dhe ndryshon gradimi, niveli i përgjithshëm i vlerësimit nga “Shumë mirë” në “Shkëlqyeshëm”.

Kalojmë në tërësi të gjithë raportin?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2022”, duke e vlerësuar atë me nivelin e përgjithshëm të vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 20.02.2024)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

3.1 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.2 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.3 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.4 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.5 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.6 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.7 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.8 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;

3.9 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;

48

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor
Tiranë, më 20.02.2024 (Pika 3)***

- 3.10 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 3.11 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 3.12 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;
- 3.13 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;
- 3.14 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Emona Muçi* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor z. *Klodian Kurushi* dhe z. *Ridvan Hado*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.

7. Arben Lila, përfaqësues të EU4Justice. (në sallë).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së.

9. Sidorela Driçi, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

10. Birn.

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

3.1 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.2 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.3 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.4 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.5 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.6 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.7 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.8 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;

3.9 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;

3.10 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.11 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.12 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile;

3.13 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale;

3.14 Për hapjen e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës penale.

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër.

Në fakt edhe kjo është një çështje shumë e rëndësishme e Këshillit, sepse ka të bëjë me hapjen e lëvizjeve paralele si premisë për krijimin e vendeve vakante, edhe për magjistratët që do të emërohen. Kështu që shkurtimisht unë do doja që t'ia jepja fjalën relatorit i cili do shpjegojë nevojën për hapjen e këtyre lëvizjeve paralele dhe në cilat gjykata, që janë në nevojë.

Alban Toro: Faleminderit!

Në kushtet kur materiali është përgatitur prej kohësh, ka pasur kohë të mjaftueshme për t'u lexuar, po e paraqes në mënyrë të sintetizuar dhe po ndaloj posaçërisht në ato pika që kanë një meritë të veçantë për t'u diskutuar.

Më herët ne stabilizuam disa gjyqtarë të cilët kishin mbetur jashtë strukture, pikërisht si një para hap i fillimit të një procedure të lëvizjes paralele për plotësimin e

vakancave pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe asaj Durrës, për efekt të plotësimit të pozicioneve që ishin të përhershme dhe që kanë cenuar në mënyrë të vazhdueshme funksionalitetin e këtyre gjykatave.

Bashkëlidhur ju kam vendosur tabelën se si paraqitet gjendja aktuale e strukturës organizative e cila parashikon 80 gjyqtarë, organika në fakt 67, efektivisht në detyrë 50 gjyqtarë për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Natyrisht nuk mund të mos vëmë edhe ngarkesën aktuale të saj e cila rezulton të jetë 21.231 çështje, ku 17.310 i takojnë lëndës civile dhe 4.101 lëndës penale. Nga paraqitja grafike e statistikës rezulton që Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ka gjithsej 31 pozicione të lira, nga të cilat 11 (duke përfshirë dhe pozicionin e gjyqtarës znj. {...}) dhe pozicionin ku kandidon i vetëm z. {...}) të përhershme dhe 20 të përkohshme.

Nga pozicionet e hapura në janar 2023 nga ana e Këshillit vijon procedura e lëvizjes paralele për 2 pozicione të lira në fushën e të drejtës civile. Për kandidatin z. Arapi i renditur i pari në pozicionin nr. 11/2023, Komisioni, në përfundim të afatit të ankimit do të përfundojë procedurat e transferimit përmes lëvizjes paralele për këtë kandidat.

Aktualisht ngarkesa e çështjeve gjyqësore e kësaj gjykate është paraqitur në tabelë dhe është bashkëlidhur.

Kalojmë tek Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës e cila në strukturën organizative ka 23 gjyqtarë, organika në fakt 14, ndërkohë që efektivisht ushtrojnë 11 gjyqtarë detyrën.

Edhe kjo gjykatë ka një ngarkesë relativisht të madhe prej 5.009 çështjesh. Aktualisht, Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës ka gjithsej 15 pozicione të lira, nga të cilat 9 të përkohshme dhe 6 të përhershme, (vlen të theksohet se Këshilli më herët ka hapur 3 pozicione të lira në fushën e të drejtës civile në procedurën e lëvizjes paralele e cila po vijon), nisur nga kjo pranë kësaj gjykate janë 6 pozicione të lira të përhershme.

Pra siç e thamë, i vetmi mekanizëm që njeh ligji për të plotësuar vakancat është fillimi i procedurës së lëvizjes paralele që herë pas here ky Këshill i ka aplikuar në disa gjykata. Duke marrë parasysh situatën e pasqyruar sa më lart në drejtim të vakancave dhe

ngarkesës dërrmuese që kanë këto dy gjykata, nga ana e Komisionit propozohet hapja e procedurës së lëvizjes paralele për 9 pozicione të lira të përhershme nga të cilat 7 në fushën e së drejtës civile dhe 2 fushën e së drejtës penale marrë në konsideratë ngarkesën në dhomat civile/penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, dhe 5 pozicione të lira të përhershme nga të cilat 3 në fushën e së drejtës civile dhe 2 fushën e së drejtës penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në përputhje me nenin 43 e vijues të ligjit “Për statusin” dhe vendimin nr.320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”.

Ky propozim bazohet nisur nga ngarkesa tepër e lartë e dhomës civile/lëndës civile respektivisht 17310 çështje civile në Tiranë dhe 3298 çështje civile në Durrës si edhe kohës së madhe mesatare për gjykimin e çështjeve civile e pasqyruar në raportin vjetor të vitit 2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, e cila është 331.7 ditë (mesatarja ligjore është 168 ditë) për gjykimin e çështjeve civile, dhe 93.8 ditë (mesatarja ligjore është 98 ditë), për gjykimin e çështjeve penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ndërkohë që në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës rezulton të jetë 208.9 ditë për gjykimin e çështjeve, në të dy fushat civile e penale pasi nga departamenti përkatës nuk disponohet në mënyrë individuale kjo ngarkesë.

Duke vlerësuar se ngarkesa prej 20.851 çështjeve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe me 5009 çështjeve në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, në kuptim të nenit 89 të Ligjit nr.115/2016 si edhe detyrimit të parashikuar në nenin 35 e në vijim të Ligjit nr.96/2016 për caktimin e 32 gjyqtarëve të rinj që pritet të mbarojnë Shkollën e Magjistraturës, do të kërkojë finalizimin e procedurave të lëvizjes paralele sa më shpejt që të jetë e mundur e ndërlidhur kjo edhe me procesin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve që do të kandidojnë, që nisur nga eksperiencia aktuale ka rezultuar e gjatë. Duke vlerësuar në përputhje me të dhënat statistikore se ngarkesa e dhomës civile në të dyja gjykatat vijon të jetë relativisht tepër e madhe dhe në respekt të parimit “të një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm”, do të sugjerohet hapja e pozicioneve në fushën civile dhe penale të

propozuar më lart.

Për të parandaluar mosrespektimin nga ana e Këshillave të Gjykatave, siç edhe ka ndodhur me disa raste të tilla, të fushës specifike ku gjyqtarët pas konkurrimit do të caktohen nga vendimmarrja e Këshillit në projekt vendim do të parashikohet një pikë e veçantë, që në kuptim të nenit 89 të ligjit 115/2016 të sanksionojë një detyrim të tillë që synon përmirësimin e ngarkesës së gjyqtarëve dhe produktivitetit të gjykatës.

Duke pasur parasysh sa më lart, ju është propozuar: Fillimi i procedurave për lëvizje paralele për 9 pozicione të lira të përhershme nga të cilat 7 pozicione në fushën e së drejtës civile dhe 2 pozicione në fushën e së drejtës penale në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe për 5 pozicione të lira të përhershme nga të cilat 3 pozicione në fushën e së drejtës civile dhe 2 pozicione në fushën e së drejtës penale në Gjykatën Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

Bashkëlidhur këtij relacioni do të gjeni informacionin e nevojshëm në lidhje me dhomat që funksionojnë pranë të dy gjykatave, ndërkohë në kohën e përgatitjes dhe përfundimit të relacionit, pritshmëria ishte të kishim edhe një “feedback” nga kryetarët përkatës, por për shkak siç duket të ngarkesës relativisht të madhe që ata kanë, ky informacion ka ardhur me vonesë. Si gjithmonë, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, për të përgatitur informacione apo vendimmarrje të tilla, merr në konsideratë edhe opinionet e përdoruesve të gjykatave dhe ata që administrojnë ngarkesën përkatëse.

Në këtë kuadër i është drejtuar të dy kryetarëve me e-mail, përmbajtja e të cilit është si më poshtë:

Në kuadër të përpjekjeve që Këshilli i Lartë Gjyqësor po bën për plotësimin e pozicioneve të përhershme si dhe në normalizimin e ngarkesës së seksioneve të gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, lutem të dërgoni me propozim të arsyetuar në lidhje me nevojat nga pikëpamja e kriterit të fushës/lëndës që ka kjo gjykatë, me qëllim vlerësimin e tyre në përputhje me ligjin për të përcaktuar në këtë rast një raport përpjesëtimor të ndarë midis dhomash nëse e konsideroni të nevojshëm.

Po e nisim nga Gjykata e Tiranës e cila thotë:

“Në përgjigje të e-mailit tuaj ju bëj me dije se Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në strukturën e miratuar nga KLGJ-ja duhet të ketë

80 gjyqtarë. Aktualisht në Dhomën Penale gjykojnë 24 gjyqtarë, ndërsa në Dhomën Civile në Seksionin Civil-Tregtar gjykojnë 26 gjyqtarë dhe në Seksionin familjar gjykojnë 6 gjyqtarë.

Për sa më sipër, për të normalizuar punën e Seksionit Civil – Tregtar duhet të gjykojnë 44 gjyqtarë dhe në Seksionin Familjar duhet të gjykojnë 9 gjyqtarë. Sa i përket Dhomës Penale duhet të gjykojnë 27 gjyqtarë, por për momentin është gati në plotësim e sipër ky seksion.

Mbetemi në plotësimin e këtyre mungesave nga ana juaj sa më shpejt.”.

Ndërkohë që nga titullari i Durrësit rezulton që nga përmbajtja e përgjigjes:

“Me implementimin e hartës së re gjyqësore, në organikën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës u caktuan 23 gjyqtarë. Me vendim të Këshillit të Gjykatës është bërë ndarja në dhoma e seksione. Aktualisht në këtë gjykatë ushtrojnë detyrën 11 gjyqtarë, duke përfshirë edhe zëvendëskryetarin e Gjykatës Durrës, Seksioni Penal përbëhet nga 6 gjyqtarë, ndërsa ai civil vetëm me 5 gjyqtarë. Ngarkesa që mbart çdo gjyqtar është tepër e lartë, nisur kjo nga çështjet e mbartura, largimi i gjyqtarëve, çështjet e ardhura në vijimësi. Është tepër e domosdoshme që në këtë gjykatë të plotësohen pozicionet e përhershme, pasi vetëm në këtë mënyrë do të normalizohet ngarkesa në seksione. Duke pasur në konsideratë nevojën për gjyqtarë që ka sistemi në këto momente, vlerësoj se në këtë gjykatë do të duhet të transferohen minimalisht 6 gjyqtarë, duke i ndarë ato në seksione.”.

Ky ishte opinioni përkatës i dy titullarëve që përfaqësojnë edhe Këshillin e Gjykatës njëkohësisht. Kështu që nuk është se ka pasur ndikim në përfundimet që kemi realizuar në relacion pasi ky është produkt i vlerësimit të marrë nga statistikat e ngarkesës përpos pozicioneve të përhershme që kanë pasur në vazhdimësi këto gjykata, kështu që propozimi mbetet i njëjtë, i pandryshuar.

Pra më lejoni të theksoj në përfundim e sipër që nuk është hapi i fundit që po ndërmerret për të plotësuar nevojat e sistemit gjyqësor, sidomos në shkallët e para, do të vijojnë më tej, duke pasur parasysh Gjykatën Administrative dhe gjykatat e vendit të cilat vuajnë nga pozicionet e përhershme. Natyrisht një vëmendje të veçantë mbetet qoftë edhe Gjykata e Apelit Tiranë në të cilën kemi pasur ndërmend edhe të krijojmë skema

delegimi apo të vijojmë hapjen e pozicioneve të reja në këtë gjykatë, por duke parë kapacitetet e Këshillit të Lartë Gjyqësor në burime njerëzore, në mënyrë të veçantë të Komisionit të Vlerësimit i cili nuk mund t'i përballojë këtë fushatë hapjesh të pozicioneve të përhershme sepse kapacitetet në burime njerëzore janë tepër të kufizuara dhe do të ishte një mision i pamundur për të realizuar, që në përfundim do të kishim të njëjtat pasoja, pozicionet e përhershme do të trajtoheshin me vonesë për t'u përfunduar. Kështu që, hap pas hapi do të vijojë përfundimi apo plotësimi i pozicioneve të përhershme me hapjen e procedurave paralele por duke pasur gjithmonë parasysh edhe kapacitetet respektive të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kam harruar t'ju citoj apo të propozoj afatin e përfundimit të anketimit. Është lënë një afat as i gjatë as i shkurtër, parashikohet data 1 mars, ku i gjithë anketimi do të mbyllet. Pra të gjithë gjyqtarët që mendojnë të garojnë, afati i fundit do të jetë data 1 mars dhe do të propozoja që të gjithë gjyqtarët e shkallëve të para t'u dërgohet me e-mail, duke parë që komunikimet nëpërmjet kryetarëve lë për të dëshiruar, t'u dërgohet e-mail i veçantë për të pasur një konkurrin sa më të mirë dhe dinjitoz apo sa më të shumtë në këtë aspekt.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit për relatimin.

Irena Plaku: Në fakt Komisioni i Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve ka një ngarkesë shumë të lartë për shkak edhe se në këtë rast nuk kemi dhe burime njerëzore dhe presim që së shpejti të na vijnë edhe tre gjyqtarë këtu dhe kjo do të përshpejtojë procedura dhe më pas ne të mbyllim të gjithë pozicionet për sa i përket vlerësimeve (atyre që kanë nevojë për vlerësim). Mund të vijojmë në rast se do të kemi një ndryshim në numrin e nëpunësve.

Naureda Llagami: Dakord.

Nëse nuk kemi diskutime, unë do propozoj që t'i kalojmë në grup të gjithë këto hapje të vendeve për lëvizje paralele.

Kështu kalojmë fillimisht për Tiranën, që propozohet hapja e 7 pozicioneve për

lëvizje paralele në fushën e së drejtës civile dhe 2 pozicione për lëvizje paralele në fushën e së drejtës penale, me afatin e konkurrimit 1 mars 2024. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohen.)

Naureda Llagami: Kalojmë në gjykatën tjetër në nevojë, që është Gjykata e Durrësit, do të hapen 3 pozicione për lëvizje paralele në fushën e së drejtës civile dhe 2 pozicione për lëvizje paralele në fushën e së drejtës penale, me afatin përfundimtar të konkurrimit që është data 1 mars 2024.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-aktet, gjithashtu nga ana e administratës të mbahet parasysh propozimi i bërë nga relatori mbi njoftimin e të gjithë trupës gjyqësore për hapjen e këtyre vakancave.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 20.02.2024)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):

4.1 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

4.2 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

4.3 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

4.4 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)

4. *Emona Muçi* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor z. *Klodian Kurushi* dhe z. *Ridvan Hado*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerita Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthë.*
3. *Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*
4. *Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.*
6. *Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.*
7. *Arben Lila, përfaqësues të EU4Justice. (në sallë).*
8. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
9. *Sidorela Driçi, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.*
10. *Birn.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimeve të përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro):
 - 4.1 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

4.2 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës;

4.3 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë;

4.4 Për hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Naureda Llagami: Kalojmë në projekt-aktin tjetër që ka të bëjë me hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për 4 pozicione të lira në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Tiranë (2 në Durrës dhe 2 në Tiranë). Fjala relatorit.

Alban Toro: Edhe ky relacion pasqyron përpjekjet që bën Këshilli i Lartë Gjyqësor për të normalizuar funksionin në disa gjykata ku pozicionet e përhershme kanë krijuar probleme me funksionalitetin.

Ndërkohë më herët, me vendime individuale kemi transferuar gjyqtarin {...} dhe zotin {...} pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për një vit, ndërkohë që me vendime individuale të tjera janë transferuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë z. {...} dhe znj. {...}.

Në kushtet kur jemi në përfundim të afatit të transferimit dhe ku nevojat nuk kanë ndryshuar në këto gjykata në raport me vakancat apo ngarkesën siç cituam pak edhe në relacionin e kaluar, vijon të jetë gjendja problematike. Nuk po pasqyroj edhe një herë gjendjen e ngarkesës, vakancat, të cilat kanë krijuar probleme në funksionalitet. Po fokusohem tek skemat të cilat nuk kanë qenë në gjendje për të zgjidhur këtë problem, siç është skema e delegimit apo ajo e rregullores për gjykimin e çështjeve të veçanta për shkak të ngarkesave dhe duke qenë që në këtë aspekt transferimin ne i kemi rregulluar me akt nënligjor të veçantë dhe këtu kam parasysh vendimin 23, datë 07.02.2019 i cili përcakton rastin kur gjykata është në nevojë, pra gjithmonë kur gjykata ka një ose disa pozicione të lira të përhershme, situatë e cila cenon funksionalitetin normal të saj; rasti

flagrant i dy gjykatave të cilat jam i detyruar ta theksoj që vazhdojnë të jenë me probleme në funksionalitet dhe në ngarkesë. Kështu që, në rastin konkret, e vetmja mundësi për të ndihmuar këto gjykata në stabilizimin e përkohshëm të kësaj situate, mbetet skema e transferimit të përkohshëm, e cila ka parashikuar rastin që kur në të ndodhen gjyqtarë të transferuar më parë, dhe momentin kur bëhet rinovim i këtij afati, ku në nenin 6, pika 1 e rregullores përcaktohet se, “Në rastin e shpalljes së një pozicioni të lirë të përkohshëm në një gjykatë, në të cilën ka gjyqtarë të transferuar përkohësisht me pëlqim, dhënia e pëlqimit i kërkohet fillimisht këtij gjyqtari” dhe pikërisht kjo është procedura që është ndjekur nga ana e Komisionit. Katër gjyqtarëve z. {...}, z. {...}, z. {...}, dhe znj. {...}, propozohet që t’i dërgohet marrja e pëlqimit për të vijuar apo jo, në rast të kundërt do të bëhet shpallja përsëri e procedurës së transferimit.

Pra përfundimisht, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës i propozon Këshillit të Lartë Gjyqësor të shpallë një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e Durrës për transferim të përkohshëm deri në datën 13.03.2025.

Kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit të transferuar aktualisht aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, z. {...} dhe z. {...} si dhe kjo shpallje i drejtohet gjyqtarit të transferuar aktualisht në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë z. {...} dhe znj. {...}, të cilët ftohen për të dhënë pëlqimin për përsëritjen e transferimit të përkohshëm.

- Afati për dhënien e pëlqimit të jetë dy ditë nga njoftimi i këtij vendimi.
- Ngarkohet Komisioni i Zhvillimit të Karrierës për kryerjen e procedurave të mëtejshme të transferimit të përkohshëm.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse s’kemi diskutime, kalojmë në miratimin e projekt-akteve.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, u miratuan 4 projekt-aktet e propozuara nga Komisioni, që kanë të bëjnë me hapjen e procedurave të transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës e cila i drejtohet gjyqtarit z. {...}, më pas kemi për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës e cila i drejtohet z. {...}, më pas kemi hapjen e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë e cila i drejtohet z. {...} dhe e fundit hapja e procedurës së transferimit të përkohshëm për një pozicion të lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë që i drejtohet znj. {...}.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 20.02.2024)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të papërfunduar nga z.Ridvan Hado”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Emona Muçi* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor z. **Klodian Kurushi** dhe z. **Ridvan Hado**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
- 3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.**
- 4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
- 6. Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.**
- 7. Arben Lila, përfaqësues të EU4Justice. (në sallë).**
- 8. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 9. Sidorela Driçi, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.**
- 10. Birn.**

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të papërfunduar nga z.Ridvan Hado”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Emona Muçi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve të papërfunduar nga z.Ridvan Hado. Shkurtimeisht prezantimi i projekt-aktit do bëhet nga kryetarja e Komisionit, znj. Muçi.

Emona Muçi: Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, në zbatim të neneve 85 e vijues të ligjit nr.96/2016 “Për statusin”, nenet 61, pika 1, 63 dhe 86, të ligjit nr.115/2016, bazuar në programet e vlerësimeve për vitet 2021, ka miratuar vendimet përkatëse, për 18 gjyqtarë, ku për 4 gjyqtarë (procedura të papërfunduara) relator është caktuar z. Ridvan Hado.

Në zbatim të nenit 171, të ligjit “Për statusin” janë caktuar nëpërmjet procedurës së shortit relatori dhe nëpunësi përgjegjës për gjyqtarët për periudhën 2013-2016, konkretisht për 20 gjyqtarë që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar dhe gjyqtari relator z. Ridvan Hado ishte në 3 prej tyre si relator.

Anëtari në fjalë ka paraqitur një kërkesë për përjashtimin e tij nga këto procedura dhe me vendimin nr. 3, datë 02.02.2024 është pranuar kërkesa e tij.

Në zbatim të nenit 89 të Ligjit për Statusin, si dhe vendimeve të Këshillit, caktimi i relatorit të ri duhet të bëhet me short midis anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit Etik dhe Profesional, i cili përbëhet nga anëtarët znj.Emona Muçi; znj. Irena Plaku dhe znj.Yllka Rupa. Duke marrë në konsideratë prioritetet në vlerësime dhe shpërndarjen e barabartë të punës mes anëtarëve, Komisioni i propozon Mbledhjes Plenare, organizimin e shortit për përzgjedhjen e relatorit në procedurat e vlerësimit për gjyqtarët:

1. {...}- vlerësimi 2013-2016 (Gradim);
2. {...} - vlerësimi 2013-2016 (Gradim);
3. {...} - vlerësimi 2013-2016 (Gradim);
4. {...} – vlerësim 2017-2019;
5. {...} – vlerësim 2017-2019;
6. {...} – vlerësim 2017-2019;
7. {...}- vlerësim 2017-2019.

Në procedurën e shortit që do të zhvillohet për përzgjedhjen e relatorit për secilin gjyqtar, do të përfshihen të tre anëtarët dhe duke mbajtur parasysh, për aq sa është e mundur, barazinë e shpërndarjes së punës, është vlerësuar që për anëtaren Emona Muçi të shortohen 3 procedura vlerësimi, për anëtaren Yllka Rupa 2 procedura vlerësimi dhe për anëtaren Irena Plaku 2 procedura vlerësimi.

Mënyra e hedhjes së shortit: Në një vazo më vete duhet të vendosen në 7 shirita

letre me emrin e secilit anëtar (2 për anëtarin Irena Plaku, 2 për anëtarin znj. Yllka Rupa dhe 3 për anëtarin Emona Muçi) dhe në një vazo tjetër duhet të vendosen shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve.

Për sa më sipër, në pikën e parë të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, të papërfunduara nga z. Hado, konkretisht gjyqtarët: {...}, {...} dhe {...}.

Në pikën e dytë të projektvendimit përcaktohet caktimi i relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar, të papërfunduara nga z.Hado, periudha e vlerësimit 2017-2019, konkretisht gjyqtarët: {...}, {...}, {...} dhe {...}.

Së fundi, në projektvendim përcaktohet dhe hyrja në fuqi e tij, konkretisht menjëherë me botimin në faqen zyrtare. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ftoj administratën sipas udhëzimeve të ndajë goglat nëpër vazo për të lejuar hedhjen e shortit.

Procedura e shortit si vijon:

Vendosen në enën e parë të qelqit shiritat e letrës me emrat e gjyqtarëve: znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, {...}.

Vendosen në enën e dytë të qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: znj. Emona Muçi (tre shirita letre), znj. Yllka Rupa (dy shirita letre), znj. Irena Plaku (dy shirita letre).

Procedura e përzgjedhjes si më poshtë:

Përzgjidhet emri i parë nga vazo me shiritat e letrës së gjyqtarëve: z. {...}.
Relatore përzgjidhet znj. Yllka Rupa.

Përzgjidhet emri i dytë nga vazo me shiritat e letrës së gjyqtarëve: znj. {...}.
Relatore përzgjidhet znj. Irena Plaku.

Përzgjidhet emri i tretë nga vazo me shiritat e letrës së gjyqtarëve: znj. {...}.
Relatore përzgjidhet znj. Emona Muçi.

Përzgjidhet emri i dytë nga vazo me shiritat e letrës së gjyqtarëve: znj. {...}.
Relatore përzgjidhet znj. Emona Muçi.

Përzgjidhet emri i parë nga vazo me shiritat e letrës së gjyqtarëve: z. {...}.
Relatore përzgjidhet znj. Emona Muçi.

Përzgjidhet emri i parë nga vazo me shiritat e letrës së gjyqtarëve: z. {...}.
Relatore përzgjidhet znj. Yllka Rupa.

Përzgjidhet emri i parë nga vazo me shiritat e letrës së gjyqtarëve: z. {...}.
Relatore përzgjidhet znj. Irena Plaku.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Kalojmë në votimin e projekt-aktit?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

1. Caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimin) e gjyqtarëve që kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, të papërfunduara nga z. Ridvan Hado, si më poshtë :

- a) Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Irena Plaku;
- b) Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Emona Muçi;
- c) Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Yllka Rupa;

2. Caktimin e relatorit në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, periudha e vlerësimit 2017-2019, të papërfunduara nga z. Ridvan Hado, si më poshtë :

- a) Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Irena Plaku;
- b) Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Yllka Rupa;

- c) Për gjyqtaren znj. {...} - Relatore znj. Emona Muçi;
- d) Për gjyqtarin z. {...} - Relatore znj. Emona Muçi.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 20.02.2024)

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 3/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Vlorë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado, në mungesë relatohet nga z. Rusi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Illir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Emona Muçi*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Alban Toro*** (anëtar)
7. ***Gentiana Muçaj*** (anëtare)
8. ***Markelian Koça*** (anëtar)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor z. **Klodian Kurushi** dhe z. **Ridvan Hado**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.**
4. **Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.**
7. **Arben Lila, përfaqësues të EU4Justice. (në sallë).**
8. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**
9. **Sidorela Driçi, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.**
10. **Birn.**

RENDI I DITËS:

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin me short të relatorit për procedimin disiplinor nr. 3/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë gjykatës së shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm Vlorë”, i përgatitur nga Komisioni Disiplinor (relator z. Ridvan Hado, në mungesë raportohet nga z. Rusi).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës që edhe ky ka të bëjë me caktimin e shortit për relatorin për procedimin disiplinor nr. 3/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë

Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Shkurtimisht do relatohet nga zoti Rusi.

Ilir Rusi: Faleminderit zonja Kryetare!

Më datë 15.02.2024, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me shkresën nr. {...} prot., datë 15.02.2024, ka depozituar për shqyrtim pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, kërkesën me objekt “Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë”.

Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra” ndaj magjistratit z. {...} të parashikuar nga nenet 105, pika 1, shkronja dh dhe 111 të Ligjit nr. 96/2016.

Në këto rrethana, kur kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor, inicicion një procedurë individuale administrative në Këshill, në referim të nenit 63 të Ligjit nr. 115/2016, nga ana e Këshillit duhet të procedohet me hedhjen e shortit për caktimin e relatorit.

Lidhur me procedurën e shortit, Komisioni Disiplinor propozon që në short të përfshihen tre anëtarët e përhershëm të tij: z. Ridvan Hado, z. Ilir Rusi dhe znj. Gentiana Muçaj, në referim të nenit 16 të vendimit nr. 316, datë 14.09.2020 të Këshillit “Për miratimin e Rregullores për Procedurat Disiplinore në Këshillin e Lartë Gjyqësor”.

Nëpërmjet këtij relacioni, Komisioni Disiplinor i propozon Mbledhjes Plenare, zhvillimin e procedurës për caktimin me short të relatorit të procedimit disiplinor nr. 3/2024, të filluar ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, ftojme administratën e cila do të hedhë shortin për relatorin për procedimin disiplinor nr. 3/2024.

Procedura e shortit si vijon:

Vendosen në enën e qelqit shiritat e letrës me emrat e relatorëve: z. Ridvan Hado,
z. Ilir Rusi dhe znj. Gentiana Muçaj.

Procedura e përzgjedhjes si më poshtë:

Përzgjidhet emri i relatorit: z. Ridvan Hado.

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në votim?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Pro.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Caktimin e anëtarit të Komisionit Disiplinor, z. Ridvan Hado në cilësinë e relatorit për procedimin disiplinor nr. 3/2024, të filluar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë ndaj magjistratit z. {...}, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

* * *

(Pika 6 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 20.02.2024)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi, në mungesë relatohet nga z. Koça).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Emona Muçi* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Alban Toro* (anëtar)
7. *Gentiana Muçaj* (anëtare)
8. *Markelian Koça* (anëtar)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor z. **Klodian Kurushi** dhe z. **Ridvan Hado**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. **Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
2. **Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.**
3. **Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.**
4. **Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Dorina Prifti, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
5. **Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.**
6. **Valbona Bala dhe Olta Lolo, eksperte të EWMI-INL.**
7. **Arben Lila, përfaqësues të EU4Justice. (në sallë).**
8. **Staf nga administrata e KLGJ-së.**
9. **Sidorela Driçi, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.**
10. **Birn.**

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi, në mungesë raportohet nga z. Koça).

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti tjetër që ka të bëjë me transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë. Për më shumë detaje fjalën ia jap z. Markelian Koça. Shkurtimisht.

Markelian Koça: Faleminderit zonja Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Në emër të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës kemi paraqitur projektvendimin "Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë" dhe relacionin bashkëlidhur.

Bëj me dije se me disa vendime të datës 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka hapur katërmbëdhjetë procedura të lëvizjeve paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimin nr. 11, procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.

Afati i kandidimit për këto vende ka qenë deri më datë 01.02.2023. Brenda afatit të kandidimit për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile të shpallur me vendimin e mësipërm kanë kandiduar gjithsej 7 (shtatë) kandidatë.

Në përfundim të fazës I – verifikimit të kriterëve ligjore janë kualifikuar nga ana e Këshillit 2 (dy) kandidatë, konkretisht: i) z. {...}; ii) z. {...}.

Në përfundim të procedurës së renditjes, Këshilli me vendimin nr. 19, datë 18.01.2024 ka vendosur:

“1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 11, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...};

2. Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidateve z. {...} dhe z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Vendimi i mësipërm i është komunikuar kandidateve rregullisht. Nëpërmjet komunikimit elektronik datë 16.02.2024 Gjykata Administrative e Apelit ka konfirmuar: “... për vendimin nr. 19, datë 18.01.2024 të Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk është ushtruar ankim deri më datë 15.02.2024”.

Në këto kushte vendimi i Këshillit nr. 19, datë 18.01.2024 është i formës së prerë. Komisioni, në përputhje me përcaktimet e Kreut VII, pika 111 të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, i propozon Këshillit transferimin e kandidatit të renditur më lart, z. {...} në pozicionin e lirë në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Projektvendimi është i strukturuar në 4 pika.

Në pikën e parë përcaktohet - Transferimi i gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Në pikën e dytë përcaktohet së gjyqtari z. {...}, ngarkohet të përfundojë: të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë që ndodhen në fazën e konkluzioneve përfundimtare, çështjet civile që ndodhen në seancë gjyqësore dhe çështjet penale për të cilat ka filluar shqyrtimi gjyqësor, si edhe të gjitha çështjet ku është caktuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor për gjykimin e çështjeve të veçanta, në gjykata të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme.

Lidhur me efektet juridike të vendimit, mbajtur në konsideratë: i) situatën në Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si dhe situatën në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, kohën e nevojshme që i duhet gjyqtarit për dorëzimin e dosjeve të cilat nuk do zhvillojë gjykimin, propozohet që të efektet juridike të vendimit të fillojnë më datë 01.03.2024.

Në pikën vijuese parashikohet që një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Së fundmi, përcaktohet se ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit Markelian!

Nëse s’kemi diskutime, kalojmë në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimit të bërë nga Komisioni përkatës.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2024

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 20.02.2024)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për komandimin e gjyqtarës znj. {...} në pozicionin "Pedagoge e Brendshme" në Shkollën e Magjistraturës" (relator z. Klodian Kurushi, në mungesë relatohet nga z. Koça).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:13 dhe mbaroi në orën 13:43.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Emona Muçi*** (anëtare)
- 5. Irena Plaku*** (anëtare)
- 6. Alban Toro*** (anëtar)
- 7. Gentiana Muçaj*** (anëtare)
- 8. Markelian Koça*** (anëtar)
- 9. Yllka Rupa*** (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor z. **Klodian Kurushi** dhe z. **Ridvan Hado**.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.

4. Luan Dibra, Rezarta Taushani, Maela Alicanaj, Gentiana Agushi, Dorina Pritfi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të MD-së.

6. Valbona Bala dhe Oltia Lolo, eksperte të EWMI-INL.

7. Arben Lila, përfaqësues të EU4Justice. (në sallë).

8. Staf nga administrata e KLGJ-së.

9. Sidorela Driçi, Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës.

10. Birn.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit "Për komandimin e gjyqtarës znj. {...} në pozicionin "Pedagoge e Brendshme" në Shkollën e Magjistraturës" (relator z. Klodian Kurushi, në mungesë raportohet nga z. Koça).

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti i fundit që ka të bëjë me komandimin e gjyqtarës znj. {...} në pozicionin "Pedagoge e Brendshme" në Shkollën e Magjistraturës. Edhe për këtë akt relator është z. Koça.

Markelian Koça: Faleminderit!

Komisioni i Zhvillimit të Karrierës ka paraqitur projektvendimin "Për komandimin e gjyqtarës znj. {...} në pozicionin "Pedagoge e Brendshme" në Shkollën e

Magjistraturës”.

Në relacionin bashkëlidhur bëj me dije se Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 86, shkronja “d” dhe nenin 264 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në nenet 53, 54, 57 dhe 58 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në kërkesën e Shkollës së Magjistraturës, me vendimin nr. 659, datë 02.11.2023 ka vendosur: “Hapjen e procedurës së komandimit të gjyqtarit në Shkollën e Magjistraturës. Shpalljen e kërkesës për kandidatura, nga radhët e gjyqtarëve, për komandim në Shkollën e Magjistraturës, në pozicionin e pedagogut të brendshëm”.

Afati i paraqitjes së kërkesave për komandim është përcaktuar data 17 nëntor.

Brenda afatit të caktuar për paraqitjen e kërkesave për komandim, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor është paraqitur kërkesë vetëm një kërkesë.

Rezulton se me aktin nr. {...} dhe nr. {...}, datë 17.11.2023 pranë KLGJ-së është protokolluar kërkesa e gjyqtarës {...} aktualisht gjyqtare pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës me të cilën shpreh vullnetin për t’u komanduar në Shkollën e Magjistraturës për pozicionin “pedagog i brendshëm” me drejtim formimin vazhdues. Këshilli i Lartë gjyqësor, në bazë të opinionit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, me vendimin nr. 720, datë 06.12.2023 ka vendosur t’i dërgohet Shkollës së Magjistraturës emri i znj. {...}, e cili ka aplikuar për t’u komanduar, në pozicionin “Pedagog i brendshëm” në Shkollën e Magjistraturës, si dhe praktikën dokumentare të paraqitur prej saj, me qëllim vlerësimin e kriterit të mësimdhënies dhe kriterëve shtesë për pozicionin përkatës.”

Pasi ky vendim iu përcoll Shkollës së Magjistraturës rezulton se kjo e fundit me shkresën nr. {...} prot, 30.01.2024 na njofton se Shkolla e Magjistraturës shqyrtoi aplikimin e zonjës {...} bazuar në nenin 264 dhe 265 të ligjit 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, si dhe në pikën 3.2/b të Aneksit nr.11 të Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës dhe konstatoi se znj. {...} plotëson kriterin e mësimdhënies. Këshilli Drejtues me vendimin nr.2, datë 29.01.2024 miratoi kërkesën e saj për pedagoge të brendshme për një afat 2-vjeçar, me të drejtë përsëritje në Shkollën e Magjistraturës.

Në respektim të përcaktimit të bërë në pikën 5, të nenit 54, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka detyrimin të shqyrtojë kërkesën e paraqitur nga Shkolla e Magjistraturës brenda dy javëve nga marrja e saj, duke përcaktuar nëse është rasti dhe kushtet e komandimit.

Komisioni vlerëson se lidhur me afatin e komandimit, neni 54, pika 1, i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka parashikuar një afat maksimal të komandimit deri në pesë vjet. Prej Shkollës së Magjistraturës është kërkuar afati prej 2 vjetësh. Duke mbajtur në konsideratë se si rezultat i zbatimit të Ligjit 84/2016 datë 06.10.2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” apo të procesit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve në gjykata, në të ardhmen mund të ndodhemi në situatën e cenimit të funksionalitetit normal të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës vlerëson që në kuptim të nenit 57, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin e komandimit të parashikohet edhe mundësia e ndërprerjes së komandimit përpara afatit kur një gjë e tillë do të jetë e domosdoshme për interesat më të lartë të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës.

Sa i përket datës së fillimit të afatit të komandimit janë marrë të dhënat përkatëse nga zonja Pogaçe e cila është shprehur e gatshme që të ndërpresë menjëherë, ajo aktualisht është me raport barrë lindje, kështu që është shprehur e gatshme të ndërpresë menjëherë raportin e barrë lindjes dhe të fillojë angazhimet menjëherë pranë Shkollës së Magjistraturës.

Për sa më lart, Komisioni i propozon KLGJ-së që të komandojë .. Meqenëse është në leje barrë lindje dhe nuk i nevojitet kohë për dorëzimin e dosjeve pranë gjykatës si dhe për shkak të faktit që shkolla tashmë ka filluar me programin për angazhimet për gjyqtaren pret sa më shpejt që të fillojë punën, datën e propozojmë që të jetë e menjëhershme, pra që Këshilli të shprehet që ky vendim të hyjë në fuqi menjëherë dhe t'i njoftohet gjyqtarës që të paraqitet pranë Shkollës së Magjistraturës për fillimin e veprimtarisë. Të përcaktohet që afati i komandimit mund të ndërpritet nëse KLGJ-ja do të

konstatojë cenim të funksionalitetit normal të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksioni të Përgjithshëm Durrës. Një kopje e vendimit t’i dërgohet gjyqtarës së komanduar {...}, sipas kërkesave ligjore, në adresën postare elektronike si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Shkollës së Magjistraturës.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit z. Koca!

Jeni dakord me propozimin?

Alban Toro: Si anëtar në pakicë jam i detyruar të vijoj të shpreh mosdakordësinë për ekspertimin e burimeve tona njerëzore në institucione të cilat nuk kanë nevojën e gjykatës. Aktualisht Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës konsiderohet gjykatë në nevojë dhe nuk shikoj se si ajo mund të plotësojë nevojat e institucioneve të tjera të cilët kanë nevojë për magjistratë por jo aq të ngutshme sa çka vetë gjyqësori për gjyqtarë. Aktualisht ne thjesht po shërbejmë si katalizator për të thelluar nevojat e gjykatës në nevojë, duke cenuar parime të rëndësishme siç është aksesimi në gjykatë apo një gjykim efektiv, të cilës afateve nuk po i dihet kur mbarojnë në raport me përdoruesit e gjykatave. Dhe kështu, për të mos u kthyer në një “tartuf” të Molierit, jam i detyruar të shpreh mosdakordësinë dhe votën kundër këtij akti i cili në çdo rast dëmton interesin më të lartë të gjykatës të cilën ne po trumbetojmë se po emërojmë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Vazhdojmë.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Gentiana Muçaj: Dakord.

z. **Toro** e shprehu votën kundër pak më herët.

Fatmira Luli: Dakord.

Markelian Koça: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Emona Muçi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Komandimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin “Pedagoge e Brendshme” në Shkollën e Magjistraturës.

2. Afati i komandimit është 2 (dy) vjet dhe fillon menjëherë.

3. Komandimi ndërpritet në rastin e verifikimit të ndonjë prej kushteve ndaluese të komandimit.

4. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Shkollës së Magjistraturës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Me kaq po e mbyllim mbledhjen për sot. Faleminderit!

Punë të mbarë!

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor